



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3319/ 14 prot.

Datë 18.12.2024

V E N D I M
Nr. 1807/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.12.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr.REF-21632-09-25-2024, me objekt “Blerje Materiale Pastrimi”, me fond limit 16 562 250 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa T.V.SH ose 167 329 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njëzetë e nëntë) Euro, kursi kembimit 98.98 all/euro, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë, datë 25.09.2024, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.10.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK dhe lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Anbim” SHPK

në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr.REF-21632-09-25-2024, me objekt “*Blerje Materiale Pastrimi*”, me fond limit 16 562 250 (*gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë*) lekë pa T.V.SH ose 167 329 (*njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njëzetë e nëntë*) Euro, kursi kembimit 98.98 all/euro, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë, datë 25.09.2024, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.10.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “*Anbim*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr.REF-21632-09-25-2024, me objekt “*Blerje Materiale Pastrimi*”, me fond limit 16 562 250 (*gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë*) lekë pa T.V.SH ose 167 329 (*njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njëzetë e nëntë*) Euro, kursi kembimit 98.98 all/euro, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë, datë 25.09.2024, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.10.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*Anbim*” SHPK, me NIPT L81618008J, me adresë: Autostrada “Tiranë – Durrës”, Km 1, Tiranë.

Operatori ekonomik “*Besim Kamberi*” PF, me NIPT L42103023G, me adresë: Rruga “Qelqit”, Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK me NIPT K91624505Am me adresë: Fshati Ahmetaq, pran firmës Ital Kon, Vorë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Adresa: Rruga “Barrikadave”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlora limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Ankimuesit e tjerë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.09.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr.REF-21632-09-25-2024, me objekt “*Blerje Materiale Pastrimi*”, me fond limit 16.562.250 (*gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë*) lekë pa T.V.SH ose 167.329 (*njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njëzetë e nëntë*) Euro, kursi kembimit 98.98 all/euro, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë, datë 25.09.2024, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.10.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 28.10.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të Autoritetit Kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 31.10.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Anbim” SHPK	11,884,900	lekë skualifikuar
2. “Euro Mega 2010” SHPK	11,999,500	lekë kualifikuar
3. “Besim Kamberi” PF	12,188,500	lekë kualifikuar
4. “Murati D” SHPK	12,421,800	lekë kualifikuar
5. “Atlantik 3” SHPK	13,550,000	lekë skualifikuar
6. “I&V Company” SHPK	13,629,500	lekë kualifikuar
7. “Malvina Visoka” PF	16,196,000	lekë skualifikuar

II.4. Në datën 28.10.2024, operatori ekonomik “Anbim” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë vijon:

Kriteret e veçanta, kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2.2.1 operatori ekonomik ka paraqitur bilance të cilat kanë raport negativ (aktiv-pasiv) në vitet e njëpasnjëshme 2021-2022, 2022-2023.

II.5. Në datën 05.11.2023, është Publikuar Njoftim - Fituesi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 11.11.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2023/4773, dhe nr. 3319/2024 prot, datë 12.11.2024 e operatorit ekonomik “Anbim” SHPK, nëpërmjetsë cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës

së tij dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në këtë procedurë prokurimi me argumentat si më poshtë vijon:

Arsye e skualifikimit nga AK, eshte si vijon: “Kriteret e vecanta, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.1 operatori ekonomik ka paraqitur balance të cilat kanë raport negative (aktiv-pasiv) në vitet e njëpasnjëshme 2021-2022, 2022-2023”. Po e paraqisim ankesën ne zbatim te neneve 109,110, 111,113 te LPP si dhe nenit 94 te VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik. Kriteri i vecante i kërkuar sipas dst eshte ne zbatim te pikës 4 te nenit nenit 43 sipas te cilit: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Ne DT ne piken 2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar kerkohet 1. kopje të certifikuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2022, 2023 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Pra qe OE ta përmbush kete kriter duhet qe dy bilance te njëpasnjëshme duhen te jene me raport pozitiv ne përfundim te vitit ekonomik. Ne si OE, jo vetëm 2 po te tre bilancet i kemi me raport pozitiv, dhe perkete arsye kontestojmë shkeljen e bere nga AK me skualifikimin e pabazuar ne asnjë baze ligjore. Konkretisht

<i>Periudha</i>	<i>2021</i>	<i>2022</i>	<i>2023</i>	<i>Komente</i>
<i>Aktivi</i>	<i>xxxxxxx</i>	<i>xxxxxxx</i>	<i>xxxxxxx</i>	
<i>Detyrimet total</i>	<i>xxxxxxx</i>	<i>xxxxxxx</i>	<i>xxxxxxx</i>	
<i>Kapitali</i>	<i>xxxxxxx</i>	<i>xxxxxxx</i>	<i>xxxxxxx</i>	
<i>Koeficienti aktiv/Deyrime pasiv</i>	<i>xxxxxxx</i>	<i>xxxxxxx</i>	<i>xxxxxxx</i>	
<i>Fitimi pozitiv</i>	<i>xxxxxxx</i>	<i>xxxxxxx</i>	<i>xxxxxxx</i>	

Nga tabela rezulton qe raporti aktiv pasiv ne asnje vit nuk eshte negativ gjithashtu dhe fitimi.

Gjithashtu, kërkojmë edhe skualifikim e OE Euro Mega 2010, ne zbatim te konstatimeve te cilat janë si me poshtë vijon:

Kerkojme refuzimin e ofertes se OE Euro Mega 2010 per arsyet e mposhtem:

Ne dokumentat standarte te tenderit nga ana e AK eshte kerkuar si me meposhte ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.

Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kërkuara dhe raport analizat dhe skedat teknike e të sigurisë të depozituara në SPE.

Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPCK-ve, Rruga e Barrikadave, Cerdhja Nr.1 Tiranë.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Ne faqen zyrtare të APP është botuar katalogu i materialeve të pastrimit ku ne të sqarohet etiketimi dhe ambalzhimi gjithashtu AK ka kerkuar mostra per 9 artikuj me qellim qe te shohe perputhjen e tyre me specifikimet teknike ne vendimin Nr 669, date 28.09.2011 Mbi etiketimin dhe te dhenat e perberseve per detergjente jepet cfare duhet te permbaje etiketa dhe keto te dhena duhet te jene ne perputhje me specifikimet e kerkuara nga AK mendojme qe specifikimet teknike te kerkuara nga AK nuk pasqyrohen ne etiketat e mostrave te dorzuara nga OE Euro Mega 2010 dhe keto produkte nuk jane ne perputhje me ligjin nr. 10216, datë 21.01.2010 Mbi Detergjentet dhe VKM nr. 669, datë 28.09.2011. Mos zbatimi i ligjit nr. 10216 datë 21.01.2010 Mbi detergjentet dhe VKM nr. 669 datë 28.09.2011 e ben oferten e OE Euro Mega 2010 te mos jete ne perputhje me kerkesat e DT dhe prandaj duhet te refuzohet operatori ekonomik Euro Mega 2010 nuk eshte prodhues i pluhurit lares dhe as i sapunit ai eshte prodhues vetem i detergjenteve liquide (te lengshem) sasia e kerkuar nga AK per keto produkte eshte detergjent pluhur lares 15000 kg, sapun 1900 kg ne specifikimet teknike per pluhurin lares kerkohet permbajtje e perboratit te natrumit te jete 10-11%.

Ky eshte nje perberes qe sherben per ti dhene bardhesi rrobave te lara sot ne detergjentet pluhur ky perberes duke patur nje kosto relativisht te larte eshte zevendesuar nga perkarbonati i natrumit i cili eshte shume me efikas ne zbardhjen e rrobave dhe me nje kosto shume me te ulet duke mos qene prodhues per kete produkt ngrejme dyshimin qe analiza e ketij perberesi nga OE Euro Mega 2010 nuk eshte i sakte gjithashtu mendojme a ekziston ne etiketen e OE Euro Mega 2010 ky perberes sepse eshte mbi 10% dhe eshte detyrim ligjor te pasqyrohet ne etikete kerkojme qe ky tregues te analizohet nga laboratore te certifikuar per te gjitha arsyet e permendura oferta e OE Euro Mega 2010 nuk eshte ne perputhje me datën prandaj duhet te refuzohet.

II.7. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3319/2 prot., datë 12.11.2024, janë publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes si dhe kriteret e kualifikimit për të cilat ngre pretendime operatori ekonomik ankimes “Anbim” SHPK, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, i cili kundërshton me anë të ankesës me nr. 3319 prot., datë 12.11.2024.

II.8. Me datë 15.11.2024, me nr. 3319/3 prot pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar dokumentacion shtesë nga operatori ekonomik ankimes “Anbim” SHPK.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 3319/4 prot, datë 19.11.2024, nga operatori ekonomik të interesuar “Euro Mega 2010” SHPK, sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.10. Me shkresën e datës 20.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3319/5 prot., datë 20.11.2024 (nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), si dhe me shkresën nr. 1653/11 prot, datë 20.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3319/7 prot, datë 25.11.2024, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur mos pranimin ankesës nr. 3319 prot, datë 12.11.2024, të operatorit ekonomik ankimues “Anbim” SHPK.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 3319/6 prot, datë 25.11.2024, nga operatori ekonomik ankimues “Anbim” SHPK.

II.12. Me shkresën nr. 1505/6 prot, datë 26.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3319/8 prot, datë 02.12.2024 autoriteti kontraktor ka kërkuar përshejtimin e shqyrtimit të ankesave.

II.13. Me qëllim shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues, me anë të shkresës nr. 3319/9 prot., datë 04.12.2024, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor që të dërgojë pranë KPP-së mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK dhe operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK pranë autoritetit kontraktor së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre.

II.14. Me shkresën nr. 1505/7 prot, datë 03.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3319/10 prot, datë 06.12.2024 autoriteti kontraktor ka kërkuar përshejtimin e shqyrtimit të ankesave.

II.15. Me shkresën nr. 1712/10 prot, datë 06.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3319/11 prot, datë 06.12.2024, me objekt: “Kthim Përgjigje”, autoriteti kontraktor ka dërguar mostrat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë “Anbim” SHPK dhe operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK pranë autoritetit kontraktor, së bashku me dokumentacionin shoqërues.

II.16. Referuar informacionit të Autoritetit Kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 31.10.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Anbim” SHPK	11,884,900	lekë skualifikuar
-----------------	------------	-------------------

2. “Euro Mega 2010” SHPK	11,999,500	lekë kualifikuar
3. “Besim Kamberi” PF	12,188,500	lekë kualifikuar
4. “Murati D” SHPK	12,421,800	lekë kualifikuar
5. “Atlantik 3” SHPK	13,550,000	lekë skualifikuar
6. “I&V Company” SHPK	13,629,500	lekë kualifikuar
7. “Malvina Visoka” PF	16,196,000	lekë skualifikuar

II.17. Në datën 31.10.2024, operatori ekonomik “*Besim Kamberi*” PF, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.18. Në datën 05.11.2023, është Publikuar Njoftim - Fituesi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.19. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 14.11.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2023/4789, dhe nr. 3360/2024 prot, datë 14.11.2024 e operatorit ekonomik “*Besim Kamberi*” SHPK, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK dhe lënien të skualifikuar operatorin ekonomik “*Anbim*” SHPK në këtë procedurë prokurimi me argumentat si më poshtë vijon:

A. Autoriteti kontraktor ka kualifikuar operatorin ekonomik Euro Mega 2010. Autoriteti kontraktor do të duhej të skualifikonte këtë operator ekonomik për arsyet si më poshtë vijojnë:

1. Në dst, 2.3 kapaciteti teknik, pika 2.3.1 kërkohet:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ne nje vlere jo me te vogel se 40% e vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit.

- Operatori ekonomik per te vertetuar pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasisë dhe llojin e mallrave të furnizuara.

- Operatori ekonomik per te vertetuar pervojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasisë dhe llojin e mallrave të furnizuara.

Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës. Duke mos plotësuar këtë kriter autoriteti kontraktor ka patur detyrimin që të skualifikojë operatorin ekonomik Euro Mega 2010.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik Euro Mega 2010 nuk është i plotësuar në formatin e kërkuar sipas ligjit. Duke parë vendime të KPP-së mbi këtë operator ekonomik, si dhe paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të këtij operatori ekonomik na rezultoi që nuk përmbushet në formën e duhur nga ligji. Konkretisht të gjitha fushat ku operatorit ekonomik ka patur detyrimin të plotësojë për të dhënë informacion paraprak në mënyrë që AK të ketë akses për verifikimin e tyre nuk i ka plotësuar si dhe nuk janë të vulosura dhe firmosura në cdo faqe.

3. Referuar ekstraktit të kësaj shoqërie shohim që vendet e ushtrimit të aktivitetit të saj janë:

- Fshati Ahemtaq, Preze, pranë firmes Ital Kon, Tiranë Selia Qëndrore.
- Rruga e Kavajes, ndertim nje katesh nr. 2, pranë Ambasades Turke, Tiranë.
- Njesia Bashkiake nr. 6, Rruga Hamdi Pepa, nr. 8, brenda ambjentëve të tregut ushqimor, Tiranë.

Praktikisht ky operator ekonomik për këto 3 vende të ushtrimit të aktivitetit do të duhet të ketë dokumentacionin përkatës lidhur me pikat e) Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit (e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Përsakohet që ky operator ekonomik ka dorëzuar pranë ak vetëm një vërtetim debie sa i takon selisë qendrore dhe jo për kontratat aktive që ka me OSHEE, AK do të duhet të verifikojë me kujdes këtë vërtetim dhe në këtë kuadër kjo pikë është e pa plotësuar nga ky operator ekonomik. Si e tillë AK ka detyrimin ligjor të skualifikojë operatorin ekonomik Euro Mega 2010.

4. Referuar ekstraktit të kësaj shoqërie rezultoi që administratori është znj. R. Sh dhe ortak z. H.Sh. Operatori ekonomik ka patur detyrimin ligjor për të deklaruar si dhe dorëzuar dokumentacion provues sa i takon pikat c), ç) dhe d) tek Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit:

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për cdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sa më sipër operatorit ekonomik Euro Mega 2010 ka patur detyrimin ligjor për të dorëzuar dokumentacion provues si për administratorin ashtu edhe për ortakun e saj për pikat e lartpërmendura.

5. Në DST autoriteti kontraktor ka parashikuar në pikën 2.3.6 - ditën e hapjes së ofertave, operatorit ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara dhe raport analizat dhe skedat teknike e të sigurisë të depozituara në SPE.
- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DOÇK-ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

Ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara dhe raport analizat dhe skedat teknike e të sigurisë të depozituara në SPE.
- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPÇK-ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

Nga dorëzimi i mostrave të këtij operatori ekonomik kemi vënë re mospërputhje të tyre me specifikimet teknike, konkretisht për artikujt si më poshtë:

Zëri nr. 6 “Peceta pastrimi”

Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (të jenë të ambalazhuara nga fabrika në pako. Çdo Pako të përmbajë 3 copë. Të jenë të forta dhe të lahen me ujë. Pecetat duhet të kenë përmasat: Gjerësi 36-40 cm gjatësi 38-42cm).

Mostra e dorëzuar nga operatori ekonomik Euro Mega 2010 është i markes Miss Gravity e cila nuk përmban asnjë lloj të dhëne tjeter përvec barkodit dhe as emër prodhuesi apo ambalazhuesi, nr. cel e të dhëna të tjera. Më kryesorja nuk përmban specifikimet teknike që ka kërkuar autoriteti kontraktor të cilat janë përmasat gjërësi 36-40 cm dhe gjatësi 38-42 cm. Me këtë produkt operatori ekonomik ka krijuar konfuzion dhe autoriteti kontraktor e ka pranuar duke mos pasur asnjë lloj informacioni që produkti është sipas specifikimeve. Duke mos pasur specifikimet e kërkuara nga AK, ky është një produkt shumë i lirë në treg cka ndikon drejtpërdrejtë në ofertimin e operatorëve ekonomik.

Bashkëlidhur ankesës sonë do të gjeni foto për këtë produkt si dhe matjen që kemi kryer ku Dallohen qartë përmasat e saj dhe mospërputhja me specifikimet teknike.

Zëri nr. 18 “Leter higjenike”

Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (letrat higjenike duhet të jenë “rulon” të paketuara në pako (qeske) me nga 10 rulon secila. Çdo rulon duhet të jetë i ndarë në jo më pak se 130 -150 nën-ndarje të vogla me përmasa: Gjerësia e nën-ndarjes jo më pak se 9-10 cm. Gjatësia e nën-ndarjes jo më pak se 11-12 cm. Numri i shtresave të letrës: 3-4 shtresa. Pesha

specifike e një ruloni: 100-150 gr. Përbërja: 100% celulozë. Letrat higjenike duhet të jenë të paketuara në qeskë plastike të tejdukshme ku të jetë stampuar: marka e produktit, kodi dhe të dhënat e plota të prodhuesit, numri i rulonëve në një paketim, numri i nën-ndarjeve të një ruloni, përmasat e nën-darjes, pesha specifike (neto) e një ruloni, numri i shtresave të letrës dhe përbërja.) Mostra e dorzuar nga operatori ekonomik Euro Mega 2010 është e markës Elisabet e prodhuar nga firma "Elisabet" import-export, rruga – Korçë - Bilisht, km 1. Ky produkt ka të shënuar të dhëna vetëm këto si më poshtë: shtresa - 3 shtresa rulona - 10 rulon prej 180 prerje

Ndërkohë nuk ka të shënuar

Gjerësin e nën-ndarjes -----

Gjatësin e nën-ndarjes -----

Perberja -----

Pesha specifike e një ruloni është më kryesorja sepse letrat higjenike apo të duarve cmimi i tyre varjon vetëm nga pesha që ka produkti dhe lënda e parë blihet me kg dhe po ashtu cmimi vendoset në shitje për gramatur. Duke mos përshkruar peshën e saj operatori ekonomik mund të prodhojë një cilësi shumë të dobët duke ndikuar drejtperdrejtë në cmimin e ofertuar dhe vendosur operatorët e tjerë në kushte jo të barabarta. Gjithashtu fakti që nuk ka asnjëlloj përshkrimi të përbërjes së saj (çka do të thotë që mund të jetë edhe e ricikluar) mund të rrezikojë shëndetin e fëmijëve duke patur parasysh rëndësinë e kësaj kontrate kur flasim për objektin dhe për kë kategori do të përdoren këto produkte. Bashkëlidhur ankesës sonë do të gjeni foto për këtë produkt ku dallohet qartë mospërputhja me specififikimet teknike

Zëri nr. 13 "Kova (me mekanizem shtrydhje)"

Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (të jenë të një madhësie jo më pak se 15 litërshe, të pajisura me dorezë për ngritjen e kovës dhe aparatit shtrydhës për shtrydhjen e shtupës. Të jetë material plastiki forte, i plotë dhe pesha totale e kovës së bashku me shtrydhësen, të jetë jo më pak se 540 gr). Mostra e dorzuar nga operatori ekonomik Euro Mega 2010 është prodhim i kompanisë enes dhe në etiketën e produktit nuk ka asnjë lloj shënimi 560 gr. Bashkëlidhur ankesës sonë do të gjeni foto për këtë produkt ku dallohet qartë mospërputhja me specififikimet teknike.

Zëri nr. 14 "Fshesa me bisht"

Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (fshesa për pastrimin e ambienteve të jashtme dhe të brendshme. Fshesa të jetë me bazament plastik me gjatësi 25-27 cm, gjerësi 4-5 cm dhe me fije të gjata 8-10 cm dhe me fileto për montimin e bishtit. Të jenë plastike me fije të dendura dhe të buta. Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri. Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e fshesës. Gjatësia e bishtit 110-130 cm) Mostra e dorzuar nga operatori ekonomik Euro Mega 2010 është prodhim i kompanisë Cadi Group shpk Kosovë. Emërtimi i produktit është Cadi Ceaning. Ngjyra e kapakut është gri me gominë të verdhë anësore dhe fije fshese ngjyre gri dhe të verdhë. Në bazë të etiketës së produktit vem re që nuk ka të shënuar në asnjë lloj vendi sa janë përmasat e produktit, fijes, plastikës etj. Gjithashtu dhe bishti i dorëzuar nga operatori ekonomik është bisht metalik me veshje plastike ngjyrë e kuqe me kapat të zinj dhe nuk ka të shënuar në etiket gjatësin e bishtit

por vetëm barkodin. Bashkëlidhur ankesës sonë do të gjeni foto për këtë produkt ku dallohet qartë mospërputhja me specifikimet teknike.

Zëri nr. 15 “Shtupa me bisht”

Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (shtupa duhet të jetë me fibra viskoze tekstili, pambuku, me gjatësi 30-35 cm dhe me fileto për montimin e bishtit. Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri. Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e shtupës. Gjatësia e bishtit 110-130 cm.) Mostra e dorzuar nga operatori ekonomik Euro Mega 2010 përmban vetëm emërtimin e prodhuesit por asnjëlloj të dhëne mbi specifikimet të cilat përshkruhen në kriter. Bashkëlidhur ankesës sonë do të gjeni foto për këtë produkt ku dallohet qartë mospërputhja me specifikimet teknike.

B. Lidhur me operatorin ekonomik “Anbim” kërkojmë të mbetet i skualifikuar për të njëjtën arsye të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor si dhe shtojmë arsyet e më poshtme:

Në DST autoriteti kontraktor ka parashikuar në pikën 2.3.6 – “Ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara dhe raport analizat dhe skedat teknike e të sigurisë të depozituara në SPE.
- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPCK-ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

Ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara dhe raport analizat dhe skedat teknike e të sigurisë të depozituara në SPE.
- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPCK-ve, Rruga e Barrikadave, Cerdhja nr.1 Tiranë.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

Nga dorëzimi i mostrave të këtij operatori ekonomik kemi vënë re mospërputhje të tyre me specifikimet teknike, konkretisht për artikujt si më poshtë:

Zëri nr. 6 “Peceta pastrimi”

Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (të jenë të ambalazuara nga fabrika në pako. cdo pako të përmbajë 3 copë. Të jenë të forta dhe të lahen me ujë. Pecetat duhet të kenë

përmasat: gjerësi 36-40 cm gjatësi 38-42cm.) Mostra e dorzuar nga operatori ekonomik Anbim është produkt i cili nuk përmban asnjëlloj të dhëne tjetër vec barkodit, as emër prodhuesi apo ambalazhuesi, nr. cel, etj. Më kryesorja nuk përmban specifikimet teknike që ka kërkuar autoriteti kontraktor të cilat janë përmasat gjerësi 36-40 cm dhe gjatësi 38-42 cm. Me këtë produkt operatori ekonomik ka krijuar konfuzion dhe autoriteti kontraktor e ka pranuar duke mos pasur asnjë lloj informacioni që produkti është sipas specifikimeve. Duke mos pasur specifikimet e kërkuara nga AK, ky është një produkt shumë i lirë në treg cka ndikon drejtpërdrejtë në ofertimin e operatorëve ekonomik.

Zëri nr. 18 “Leter higjenike”

Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (letrat higjenike duhet të jenë “rulonë” të paketuara në pako (qeske) me nga 10 rulonë secila. Cdo rulon duhet të jetë i ndarë në jo më pak se 130 -150 nën-ndarje të vogla me përmasa: gjerësia e nën-ndarjes jo më pak se 9-10 cm. Gjatësia e nën-ndarjes jo më pak se 11-12 cm. Numri i shtresave të letrës: 3-4 shtresa. Pesha specifike e një ruloni: 100-150 gr. Përbërja: 100% celulozë. Letrat higjenike duhet të jenë të paketuara në qeskë plastike të tejdukshme ku të jetë stampuar: marka e produktit, kodi dhe të dhënat e plota të prodhuesit, numri i rulonëve në një paketim, numri i nën-ndarjeve të një ruloni, përmasat e nën-darjes, pesha specifike (neto) e një ruloni, numri i shtresave të letrës dhe përbërja.) Mostra e dorzuar nga operatori ekonomik Anbim është e markës Ecoline e prodhuar nga prodhuesi Paper Albania. Produkti në fjalë ka të shënuar të dhëna vetëm këto si me poshtë: Shtresa - 3 shtresa

Rulona - 10 rulon

Përbërja 100% celuloze

Ndërkohe nuk ka të shënuar

Gjerësinë e nën-ndarjes -----

Gjatësinë e nën-ndarjes -----

Ndarjet e rulonit-----

Pesha specifike e një ruloni është më kryesorja sepse letrat higjenike apo të duarve cmimi i tyre varjon vetëm nga pesha që ka produkti dhe lënda e parë blihet me kg dhe po ashtu cmimi vendoset në shitje për gramatur. Duke mos përshkruar peshën e saj operatori ekonomik mund të prodhojë një cilësi shumë të dobët duke ndikuar drejtpërdrejtë në cmimin e ofertuar dhe vendosur operatorët e tjerë në kushte jo të barabarta. Bashkëlidhur ankesës sonë do të gjeni foto për këtë produkt ku dallohet qartë mospërputhja me specifikimet teknike.

Zëri nr. 13 “Kova (me mekanizem shtrydhje)”

Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (të jenë të një madhësie jo më pak se 15 litërshe, të pajisura me dorezë për ngritjen e kovës dhe aparatit shtrydhës për shtrydhjen e shtupës. Të jetë material plastiki forte, i plotë dhe pesha totale e kovës së bashku me shtrydhësen, të jetë jo më pak se 540 gr). Mostra e dorzuar nga operatori ekonomik Anbim ka etiketën e produktit dhe në të nuk ka asnjë lloj shënimi 560 gr.

Zëri nr. 14 “Fshesa me bisht”

Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (fshesa për pastrimin e ambienteve të jashtme dhe të brendshme. Fshesa të jetë me bazament plastik me gjatësi 25-27 cm, gjerësi 4-5 cm dhe me fije të gjata 8-10 cm dhe me fileto për montimin e bishtit. Të jenë plastike me fije të dendura dhe të buta. Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri. Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e fshesës. Gjatësia e bishtit 110-130 cm). Mostra e dorëzuar nga operatori ekonomik Anbim ka etiketën e produktit ku në të cilën vem re që nuk ka të shënuar në asnjë lloj vendi sa janë përmasat e produktit, fijes, plastikës etj. Gjithashtu dhe bishti i dorëzuar nga operatori ekonomik është bisht metalik me veshje plastike ngjyrë e kuqe me kapat të zinj dhe nuk ka të shënuar në etiket gjatësin e bishtit por vetëm barkodin.

Zëri nr. 6 “Peceta pastrimi”

Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (të jenë të ambalazhuara nga fabrika në pako. Cdo pako të përmbajë 3 copë. Të jenë të forta dhe të lahen me ujë. Pecetat duhet të kenë përmasat: Gjerësi 36-40 cm Gjatësi 38-42cm). Mostra e dorëzuar nga operatori ekonomik Anbim nuk ka të shënuar në ambalazhim në asnjë lloj vendi të gjitha specifikimet teknike. Ajo nuk përmban elementin 70 fije si dhe pesha e produktit nuk paraqitet.

Zëri nr. 15 “Shtupa me bisht”

Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (shtupa duhet të jetë me fibra viskoze tekstili, pambuku, me gjatësi 30-35 cm dhe me fileto për montimin e bishtit. Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri. Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e shtupës. Gjatësia e bishtit 110-130 cm). Mostra e dorëzuar nga operatori ekonomik Anbim përmban vetëm emërtimin e prodhuesit por asnjëlloj të dhëne mbi specifikimet të cilat përshkruhen në kriter.

Sa më sipër kërkojmë:

- 1. Operatori ekonomik Anbim të qëndrojë i skualifikuar.*
- 2. Skualifikimin e operatorit ekonomik Euro Mega 2010.*

II.20. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3360/2 prot., datë 15.11.2024 janë publikuar kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimes “Besim Kamberi” PF pretendon se nuk përmbushen nga nga operatorët ekonomikë “Euro Mega 2010” SHPK dhe “Anbim” SHPK.

II.21. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 3360/3 prot, datë 19.11.2024 nga operatori ekonomik i interesuar “Euro Mega 2010” SHPK, sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.22. Me shkresën e datës 21.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3360/4 prot., datë 21.11.2024 (nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), si dhe me shkresën nr. 1712/8 prot, datë 21.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3360/5 prot, datë 25.11.2024, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur mos pranimin ankesës nr. 3360 prot, datë 14.11.2024, të operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” PF.

II.23. Referuar informacionit të Autoritetit Kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 31.10.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Anbim” SHPK	11,884,900	lekë skualifikuar
2. “Euro Mega 2010” SHPK	11,999,500	lekë kualifikuar
3. “Besim Kamberi” PF	12,188,500	lekë kualifikuar
4. “Murati D” SHPK	12,421,800	lekë kualifikuar
5. “Atlantik 3” SHPK	13,550,000	lekë skualifikuar
6. “I&V Company” SHPK	13,629,500	lekë kualifikuar
7. “Malvina Visoka” PF	16,196,000	lekë skualifikuar

II.24. Në datën 31.10.2024, operatori ekonomik “Euro Mega” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.25. Në datën 05.11.2023, është Publikuar Njoftim - Fituesi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.26. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 15.11.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2023/4799, dhe nr. 3379/2024 prot, datë 18.11.2024 e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, nëpërmjet së cilës kërkon lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Anbim” SHPK në këtë procedurë prokurimi me argumentat si më poshtë vijon:

Pasi u njohëm me vendimin e Komisionit të vlerësimit të Ofertave në lidhje me vlerësimin e ofertës të ofertuar nga operatorët ekonomikë: “Anbim” SHPK vlerësojmë se, përveç arsyes për skualifikim të deklaruar nga KVO-ja, oferta e këtij operatori ekonomik duhet të skualifikohet edhe për arsyet e mëposhtme për kualifikim:

I- Ofertuesi “Anbim” SHPK nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit e konkretisht kriteret për kualifikim të përcaktuara në pikën 1/g) dhe 1/h) të shtojcës 7 të DT-së me

përmbajtjet si më poshtë vijojnë: "...g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës; h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi....";

2- Nuk plotëson kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.5/b) të kapacitetit teknik të shtojcës 7 të DT-së mëpërmbajtjen si vijon: "2.3.5.vetëm për produktet:

Nr	Emërtimi i produktit
1	Detergjent rrobash
2	Solucion larës enësh.
3	Solucion, zbardhues, dizifektues
4	Ilaç xhamash
5	Solucion pllakash
6	Sapun rrobash
7	Sapun tualeti
8	Solucion për pastrimin e sobave
9	Solucion parketi

B) Skedat Teknike dhe Skedat e sigurisë të tyre. Në skedat teknike dhe skedat e sigurisë të produktit, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kerkuara me produktet e ofruara. (Skedat teknike dhe skedat e sigurisë duhet të jenë në gjuhën shqipe, dhe nëse janë në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer e të noterizuara). Sa më sipër argumentojmë:

Shoqëria "Euro mega 2010" SHPK, është një kompani e cila ndër të tjera aktivitet të saj kryesor ka prodhimin dhe tregëtimin e detergjentëve e cila operon në treg prej vitit 2009, pra prej një kohe të gjatë dhe për pasojë njeh mirë tregun e fushës objekt i këtij prokurimi si dhe konkurentët e saj në këtë fushë, kapacitetet aftësitë e tyre si në përgatitjet e ofertave ashtu edhe kapacitetet e tyre në fushën e tregëtimit apo prodhimit të detergjentëve.

Në lidhje me kërkesën tonë për ti shtuar arsyet për skualifikim operatorit ekonomik "Anbim" SHPK, argumentojmë si më poshtë vijon:

Një nga kriteret për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik të shtojcës 7 të DT-së është si vijon:

2.3.6. Ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jene në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kerkuara dhe raport analizat dhe skedat teknike e të sigurisë të depozituara në SPE.
- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPCK-ve, Rruga e Barrikadave, Cerdhja nr.1 Tiranë.

- *Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.*

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

Në përmbushje sa më sipër përfaqësuesi i shoqërisë “Euro Mega 2010” SHPK, ka qënë prezent në autoritetin kontraktor në ditën dhe orën e caktuar për dorëzimin e mostrave nga operatorët ekonomik ofertues dhe nga ana jonë është konstatuar se ofertuesi “Anbim” SHPK, ndër të jera ka dorëzuar mostra për detergjentët me mbishkrimin iletatë, produkte për të cilat shoqëria “Anbim” SHPK, deklaroi se është prodhuese e tyre.

Nisur nga fakti se, prodhimi i detergjentëve rregullohet me ligj dhe për më tepër shoqëritë të cilat prodhojnë detergjentët referuar po legjislacionit shqiptar në fuqi duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore, leje të cilat kjo shoqëri nuk i disponon, ne jemi të bindur se ofertuesi “Anbim” SHPK, ka bërë deklarime të rreme në formularin e vetdeklarimit si dhe ka paraqitur dokumente të cilat përmbajnë informacione të rreme për qëllime kualifikimi.

Më poshtë po ju paraqesim argumentat tona për sa pretendojmë si më sipër. Në këtë procedurë prokurimi në shtojcat 5 dhe 6 të DT-së, ndër të tjera janë përcaktuar të prokurohen produktet detergjente si më poshtë vijojnë:

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi</i>
<i>1</i>	<i>Detergjent rrobash</i>
<i>2</i>	<i>Solucion larës enësh</i>
<i>7</i>	<i>Solucion, zbardhues, dizifektues</i>
<i>8</i>	<i>Ilaç xhamash (me sprucator)</i>
<i>9</i>	<i>Solucion pllakash</i>
<i>11</i>	<i>Sapun rrobash</i>
<i>12</i>	<i>Sapun tualeti</i>
<i>16</i>	<i>Solucion për pastrim sobave</i>
<i>17</i>	<i>Solucion parketi</i>

Prodhimi i detergjentëve në Shqipëri rregullohet me ligjin Nr.10216 datë 21.01.2010 “Për detergjentët” ku në nenin 1 dhe në nenin 2 të tij përcaktohet:

Në Nenin 1 (qëllimi dhe fusha e zbatimit)

Ky ligj përcakton rregullat për vendosjen në treg të detergjenteve dhe të lëndëve tensioaktive për Detergjentet, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit publik e të mjedisit, në lidhje me: “a) biodegradimin e lëndëve tensioaktive në detergjente; b) kufizimet ose ndalimin e përdorimit të lëndëve tensioaktive, për shkak të biodegradimit; c) etiketimin e detergjenteve. Përfshirë lëndët aromatike alergjene...”

Neni 2 (përkufizime) Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

A) Detergjentë është cdo substancë ose preparat, në formë të lëngët, pluhuri, paste, kallëpi, blloku, figure etj., që përmban sapune dhe/ose lëndë të tjera tensioaktive, i destinuar për t'u përdorur në proceset e larjes dhe të pastrimit, si dhe tregtohen dhe/ose përdoren për qëllime shtëpiake ose industriale.

Detergjente vlerësohen edhe produktet e mëposhtme:

B) Preparat ndihmës për larjeë, i përcaktuar për njomje (paralarje), shpëlarje ose zbardhje rrobash, tekstilësh për përdorim shtëpiak etj.;

C) Zbutës tekstilësh, i përcaktuar për të ndryshuar karakteristikat në prekje të tekstileve, në proceset që plotësojnë larjen e tyre;

Ç) Preparat pastrimi, i përcaktuar për pastruesit shtëpiakë, universalë dhe/ose pastrime të tjera sipërfaqesh.

Në Neni 10 (Etiketimi dhe paketimi) përcaktohet:

1. Detergjentet klasifikohen e paketohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9108, datë 17.7.2003 "Për substancat dhe preparatet kimike" dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në Ligjin Nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e mjedisit" i ndryshuar, përcaktohet si vijon: Neni 1 (qëllimi) Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës.

Neni 2 (Objekti) Ky ligj përcakton: a) Rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në republikën e shqipërisë; b) Masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.

Në nenin 4 (Sistemi i lejeve të mjedisit) përcaktohet: Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", krijohet një sistem prej dy nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipave A e B, si më poshtë: A) Leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/a të këtij ligji; b) Leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/b të këtij ligji;

c) shfuqizuar.

2. Autoritetet kompetente për lejet e mjedisit të tipave A dhe B janë si më poshtë:

a) Qendra kombëtare e Biznesit (QKB) është autoriteti ku bëhet kërkesa dhe ku lëshohet leja e mjedisit të tipit A dhe B;

b) Ministri është autoriteti që firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato të shqyrtohen dhe përgatiten nga Agjencia kombëtare e Mjedisit;

c) Agjencia kombëtare e Mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga QKB-ja;

ç) shfuqizuar;

d) Inspektorati Shtetëror Kompetent është autoriteti që verifikon plotësimin nga operatori të kushteve të kësaj lejeje, pas lëshimit të saj nga QKB-ja.

3. Lista e veprimtarive të përfshira dhe kushtet e lejes së mjedisit të tipave A dhe B rishikohen në cdo kohë nga ministria kur ka ndryshime në legjislacionin përkatës mjedisor, të cilit ato i përmbahen dhe në raste kur konstatohen nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nëse:

a) evidentohet ekzistenca e veprimtarive të reja që kanë ndikim në mjedis;

b) shfaqen elemente të reja ekologjike, të panjohura në kohën e dhënies së saj;

c) dalin dispozita të reja për mjedisin, që e kërkojnë shprehimisht ndryshimin e saj;

ç) vërtetohet ndotje tej normave të lejuara;

d) ka ndryshime themelore të veprimtarisë;

dh) ka përparime në fushën e teknikave më të mira të mundshme, që lejojnë pakësimin e rëndësishëm të shkarkimeve në mjedis dhe që nuk kërkojnë shpenzime të mëdha.

Në Shtojcën 1, (ndryshuar me ligjin nr. 60/2014, datë 19.6.2014, ndryshuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020), përcaktohet ndër të tjera:

Shtojca 1

Lejet e mjedisit të tipave A dhe B, në varësi të kapacitetit prodhues kufi.

Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull, si më poshtë, dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. N.q.s. Nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti kufi nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo.

Tek tabela e kësaj shtojce është përcaktuar që tek “industria kimike” për veprimtaritë: “4.1 Prodhimi i kimikateve organike bazë (2)”, të gjitha instalimet, duhet të pajsijen me lejen e tipit A;

4.2 Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (3), të gjitha instalimet duhet të pajsijen me lejen e tipit A;

Në lidhje me veprimtarinë “4.9 Prodhimi dhe përpunimi/përzjerja e produkteve të pastrimit/detergjenteve”, të gjitha instalimet duhet të pajsijen me lejen e Tipit B.

Po në këtë shtojcë është përcaktuar si vijon:

Shënime për tabelën e veprimtarive të tipit A

1. Për kategorinë 4, Industria Kimike, “prodhim” do të thotë prodhim në shkallë industriale me anë të përpunimit kimik të substancave ose grupeve të substancave të listuara në kategoritë nga 4.1 deri 4.6.

2. Kimikatet organike bazë përfshijnë, por nuk mjaftohen në:

a) hidrokarburet e thjeshta (linear apo ciklik, të ngopura ose të pangopura, alifatik ose aromatik);

b) hidrokarburet që përmbajnë oksigjen si alkoolet, aldehidet, ketonet, acidet karboksilike, esteret, acetatet, eteret, peroksidet, rezinat epokside;

c) hidrokarburet me bazë squfuri;

ç) hidrokarburet e hidrogjenuara si aminate, amidet, përbërjet nitroze, përbërjet nitrore, ose përbërjet nitrite, përbërjet nitrile, cianatet, izocianatet;

- d) hidrokarburet me përmbajtje fosfori;
- dh) hidrokarburet halogjenike; e) përbërjet organometalike;
- e) materialet me bazë plastike (polimeret, fibrat sintetike dhe fibrat me bazë celuloze);
- f) gomat sintetike;
- g) bojërat dhe pigmentet;
- gj) LËNDËT TENSIOAKTIVE.

3. Kimikatet inorganike bazë përfshijnë, por nuk mjaftohen në:

- a) gaze, si amonium, klori ose gazi kloridrik, fluoruret ose hidrogjen i fluoruar, oksidet e karbonit, përbërjet e sqfurit, oksidet e azotit, hidrogjeni, dioksid sqfuri, kloruri i karbonilit;
 - b) acidet, si acidi kromik, acidi hidroflorik, acidi fosforik, acidi nitrik, acidi hidroklorik, acidi sulfurik, oleumi, acide sulfurore;
 - c) baza, si hidroksid amoni, hidroksid potasi, hidroksid natriumi;
 - ç) kripërat, si klorur amoni, klorat potasi, karbonat potasi, karbonat natriumi, perborate, nitrat argjendi;
 - d) jo metale, oksided e metaleve ose përbërje organike të tjera si karbit, silikon, karburi i silicit.
4. Rikuperimi i mbetjeve të rrezikshme nënkupton veprimtaritë rikuperuse të mëposhtme siá përcaktohet në legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve:

R1. Përdorim kryesisht si karburant ose mjet të ndonjë lloji tjetër për gjenerim energjie.

R5. Riciklimi ose marrja e materialeve inorganike, përfshirë gazifikimin dhe pirolizen për t'iu përdorur si kimikate.

R6. Rigjenerim i acideve ose bazave.

R8. Rikuperim i komponentëve nga katalizatorët.

R9. Rirafinimi i vajit ose ripërdorime të tjera të vajit.

5. Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme nënkupton veprimtaritë asgjësuese të mëposhtme siá përcaktohen në legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve:

D8.

D9.

6. Trajtim sipërfaqësor i substancave, objekteve ose produkteve përfshin, por nuk mjaftohet në:

- a) përpunimin;
- b) stampimin/printimin;
- c) lyerjen/veshjen;
- ç) zhvajosjen;
- d) mbrojtjen nga uji;
- dh) kalibrimin/përpunimin me saktësi sipas përmasave;
- e) bojatisjen/ngjyrosjen;
- ë) pastrimin;
- f) regjien/ngopjen/njomjen në thellësi.

Në ligjin Nr.10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar përcaktohet:

Në Nenin 2 (Objekti dhe fusha e veprimtimit), përcaktohet:

"1. Ky ligj përcakton:

- a) parimet për përcaktimin e veprimtarive, të veprimeve dhe tipave të të mirave publike, ushtrimi, kryerja dhe përdorimi i të cilave u nënshtrohet licencimit, autorizimit apo lejimit;
- b) parimet për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave, autorizimeve e lejeve dhe parimet për shkaqet e procedurat e revokimit të tyre;
- c) organizimin dhe përmbajtjen e Regjistrit kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve;
- ç) procedurat për trajtimin e disa licencave, të autorizimeve dhe lejeve, në kompetencë të institucioneve qendrore;
- d) Shfuqizuar.

2. Ligji është i zbatueshëm për:

- a) të gjitha licencat e autorizimet, për qëllime të natyrës ekonomike, tregtare, profesionale dhe të cdo natyre tjetër të ngjashme, përveç atyre të natyrës vetjake;
- b) të gjitha lejet për përdorimin e të mirave publike, për qëllime të veprimtarive të sipërpërmendura, përveç përdorimit të të mirave publike për qëllime vetjake.

Në nenin 14 të ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Rrepublicën e Shqipërisë” i ndryshuar , përcaktohet: Neni 14 Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve (Ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe shfuqizuar pika 7 me ligjin nr.6/2015, datë 12.2.2015, shfuqizuar pika 7)

1. Çdo licencë/autorizim/leje në Republikën e Shqipërisë, e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura, hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në regjistrin kombëtar të licencave, autorizimeve dhe lejeve, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit, që e miraton atë, lidhet me botimin në fletoren zyrtare.

2. Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve është një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi/shpalljeje dhe si arkiv elektronik zyrtar, si dhe siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

3. Regjistri organizohet në tri pjesë:

- a) regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve;
- b) regjistri informativ, sipas kategorive të licencave, autorizimeve dhe lejeve;
- c) regjistri aplikativ i licencave dhe lejeve.

4. Regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore përmban të gjitha projektaktet e nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve, raportin përkatës të vlerësimit të pasojave dhe mendimin këshillimor të QKB-së.

5. Regjistri informativ përmban, për çdo kategori licence/autorizimi/lejeje, të paktën, këto lloje të dhënash:

- a) kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- b) kriteret dhe detyrimet e licencimit, të autorizimit apo lejimit, dokumentet shoqëruese, që duhen paraqitur dhe formularët e aplikimit;
- c) procedurat e aplikimit, të shqyrtimit dhe vendimmarrjes;
- ç) udhëzimet për bërjen e kërkesave.

6. Regjistri aplikativ përmban këto të dhëna:

- a) Cdo kërkesë për pajisjen me licencë/autorizim/leje të caktuar apo për bërjen e ndryshimeve në të;

- b) Cdo vendim të ndërmjetëm të institucioneve të tjera, të përfshira në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kushteve të licencimit/lejimit;
- c) Cdo vendim për miratimin apo refuzimin përfundimtar të një kërkesë;
- 7) Cdo vendim për urdhërimin e ripërmbushjes së kriterëve apo të ndreqjes së shkeljeve të detyrimeve të licencës/autorizimit/lejes apo pezullimin e licencës/autorizimit/lejes;
- d) Cdo vendim për revokimin e një licence/autorizimi/lejeje;
- dh) Cdo vendim administrativ apo gjyqësor, të nxjerrë për ankimet ndaj vendimeve të parashikuara në shkronjat ibë deri në idë të kësaj pike;
- e) Cdo licencë/autorizim/leje të dhënë e të vlefshme;
- ë) Vendimet e gjykatës, për heqjen titullarit të një licence/autorizimi/lejeje të së drejtës, për të ushtruar veprimtarinë e licencuar apo heqjen e së drejtës së përdorimit të së mirës publike;
- f) Cdo vendim tjetër për një licencë/autorizim/leje të caktuar.

7. Shfuqizohet.

8. Regjistri kombëtar mbahet nga QKB-ja, e cila siguron administrimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të tij.

QKB-ja, cdo institucion i pavarur dhe cdo institucion qendror, sipas shkronjës b të pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, janë përgjegjës për administrimin dhe plotësimin, sipas këtij ligji, të Regjistrit kombëtar për pjesën e licencave/autorizimeve/lejeve në kompetencë të tyre.

9. Organi nismëtar i nismës ligjore, me përjashtim kur është institucioni i përmendur në pikën 8 të këtij neni, dërgon projekt-aktin dhe raportin e vlerësimit të pasojave për publikim nga QKB-ja.

10. Cdo institucion tjetër, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji, me kompetencë në shqyrtimin e kriterëve të licencimit/autorizimit/lejes, ka akses në Regjistrin kombëtar, për të publikuar vendimin e tij në procesin e shqyrtimit të kërkesës për licencim/autorizim/leje.

11. Cdo institucion me kompetenca të caktuara për trajtimin e një kërkesë ose me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese apo që zgjidh një ankim administrativ ndaj vendimeve të marra në ushtrimin e këtyre kompetencave, ka akses të drejtpërdrejtë në regjistër, për të publikuar kërkesat, ankimet dhe vendimet përkatëse dhe është i detyruar për të publikuar, përkatësisht, ankimin dhe vendimin e tij, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligji.

12. Vendimet e gjykatës, sipas shkronjave idhë dhe iëë të pikës 6 të këtij neni, i njoftohen nga vetë gjykata, brenda 5 ditëve nga dhënia e tyre, institucionit që administron regjistrin për licencën/autorizimin/lejen, sipas kompetencës përkatëse. Njoftimi bëhet me mjete të përshtatshme.

13. Regjistri është lirisht i aksesueshëm nga publiku, me përjashtim të të dhënave, të cilat janë me akses të kufizuar apo të ndaluar, sipas legjislacionit në fuqi.

14. Ministri miraton rregullat e hollësishme për funksionimin e regjistrit, krijimin, administrimin, formatimin, përmbajtjen, lidhjen në rrjet me institucionet e përfshira në procesin e licencimit/autorizimit/lejimit, si dhe procedurat e sigurisë së tij. Pra, referuar legjislacionit të mësipër, operatorët ekonomikë të cilët prodhojnë detergjente duhe të jenë të pajisur me leje mjedisore të tipit A ose /dhe leje mjedisore të tipit B;

Nisur nga fakti se, cdo leje emarrë nga subjektet publikohet në regjistrin përkatës të QKB-së, rezulton se kjo shoqëri ka të publikuar në këtë regjistër vetëm lejen me numër LN-7526-06-

2019, me KOD: II.8.b me pershkrimin “Shërbime ndërhyrëse higjieno - shëndetësore (Deratizim, Dezinfektim, Dezinsektim)” e cila nuk ka lidhje me prodhimin e detergjentëve. Mjafton të kërkosh në linkun e QKB-së: <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/>, për të vertetuar se kjo kompani nuk ka asnjë leje medisore për prodhimin e detergjentëve edhe pse pajisja me keto leje për këtë lloj veprimtarie është e detyrueshme.

Për gjithë sa më sipër, ofertuesi “Anbim” SHPK, në kushtet kur është deklaruar si prodhues i produkteve detergjentë, në këtë procedurë prokurimi, duke mos pasur asnjë leje mjedisore të tipit A ose dhe B, për prodhim detergjentësh, ai nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit e konkretisht kriteret për kualifikim të përcaktuara në pikën 1/g) dhe 1/h) të shtojcës 7 të DT-së me përmbajtjet si më poshtë vijojnë: “g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës; h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi....”. Në kushtet kur, nga KVO-ja ky ofertues nuk rezulton të jetë i skualifikuar për këtë shkak, atëherë ky ofertues ka dorëzuar si pjesë të ofertës së tij shtojcën 8 (Formulari Përmbledhës të Vetëdeklarimit) të DT-së, formular në të cilin ka bërë edhe deklaratimet në pjesën II: Shkaqet e përjashtimit A: Deklarata për Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, me përmbajtjet si vijojnë: “...Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi....”, deklarim i cili është i rreme.

Gjithashtu duke u deklarur si prodhues ofertuesi “Anbim” SHPK, ka dorëzuar në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në kriterin për kualifikim në pikën 2.3.5/germa b) Skedat Teknike dhe Skedat e Sigurisë të tyre për 9 llojet e detergjentëve të kërkuesve në këtë kriter, të cilat përmbajnë gjithashtu informacione të rreme për qëllime kualifikimi. Në besojmë gjithashtu që ky ofertues edhe në administratën tatimore nuk ka deklaruar se ushtron aktivitetin e prodhimit të detergjentëve. Mjafton të verifikosh dokumentat e publikuara në QKB, që mund ti gjesh tek ekstrakti historik i kësaj shoqërie, ku nga analiza e pasqyrave financiare nuk rezulton që të ketë deklaruar veprimtari në fushën e prodhimit të detergjentëve, por vetëm në tregëtimin e tyre. Procedura e prokurimit, objekt i këtij ankimi, është një procedure prokurimi e realizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Crdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, pra bëhet fjalë për detergjentë të cilat do të përdoren nga fëmijë të kopshteve dhe cerdheve dhe rrezikshëmria në këtë rast është e lartë nëse ky ofertues do të shpallet fitues pasi kryen aktivitet prodhimi detergjentësh të pa kontrolluar nga institucionet përkatëse, për sa kohë as nuk deklaron të tatimet se ushtron aktivitet si prodhues detergjentësh dhe as është i pajisur me lejet respective, të cilat monitorohen sipas legjislacionit të fushës nga inspektoriatet përkatëse. Në këto kushte, KSHA-ja kërkojmë të bëhen verifikimet për sa pretenduam më sipër.

Në shtojcën 7 të DT-së “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar ndër të tjera:

Shtojca 7 [shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor] Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit 1. Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit Ofertuesi deklaron se: f) Operatori ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; g) Operatori ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me

legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës; gj) operatori ekonomik ka paraqitur një ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; h) Operatori ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në Shqip. Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së ofertës, sipas shtojcës 8. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë vetëdeklarimin e lartpërmendur. Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Në cdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, për sa më sipër.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të vecanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit dhe informacionit të paraqitur dhe deklaruar sipas rastit, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, në vlerësojmë se operatori ekonomikë pjesëmarrës "Anbim" SHPK në këtë procedurë prokurimi nuk i ka plotësuar kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit dhe për më tepër ka bërë deklarime të rreme në shtojcën 8 të DT-së në, pasi ky ofertues nuk e ushtron veprimtarinë e tij të prodhimit të detergjentëve në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor në fuqi. Referuar legjislacionit të prokurimit publik, ofertuesit janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Një nga parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për Prokurimin publik". Respektimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur ato vlerësohen.

Në rastin konkret, nga KVO-ja, është marrë i mirëqënë fakti pa bërë asnjë lloj verifikimi se, ofertuesi "Anbim" SHPK e ushtron aktivitetin e tij të prodhimit të detergjentëve, duke respektuar legjislacionin përkatës mjedisor, ndërkohë që referuar sa argumentuam në këtë ankesë ky ofertues nuk ka asnjë lloj leje mjedisore të miratur në përputhje me ligjin nr. 10 448,

datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, edhe pse është e detyrueshme pajisja me leje mjedisore të tipit A ose dhe B, për prodhim dhe përpunim detergjentës apo kimikatesh.

Për gjithë sa më sipër, kërkojmë shtimin e arsyeve për skualifikim për ofertën e dorëzuar nga ofertuesi “Anbim” SHPK, sipas arsytimit të bërë në këtë ankesë, si oferta të cilat nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor e konkretisht: për Ofertuesin “Anbim” SHPK, të shtohen arsyet për skualifikim:

1- Ofertuesi “Anbim” SHPK nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit e konkretisht kriteret për kualifikim të përcaktuara në pikën 1/g) dhe 1/h) të shtojcës 7 të DT-së me përmbajtjet si më poshtë vijojnë: “...g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës dhe h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, pasi e ushtron aktivitetin e prodhimit të detergjentave, i papajisur me leje mjedisore të tipi A ose dhe të Tipit B në përputhje me kërkesat e Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar;

2- Nuk plotëson kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.5/b) të kapacitetit teknik të shtojcës 7 të DT-së mëpërmbajtjen si vijon: “2.3.5.vetëm për produktet: Nr emërtimi i produktit 1- Detergjent rrobash, 2- Solucion larës enësh, 3- Solucion zbardhues, dizifektues, 4- Ilaç xhamash, 5- Solucion pllakash, 6- Sapun rrobash, 7- Sapun tualeti, 8- Solucion për pastrimin e sobave, 9- Solucion parketi.

b) Skedat Teknike dhe Skedat e Sigurisë të tyre. Në skedat teknike dhe skedat e sigurisë të produktit, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kërkuara me produktet e ofruara. (Skedat teknike dhe skedat e sigurisë duhet të jenë në gjuhën shqipe, dhe nëse janë në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer e të noterizuara), pasi skedat teknike dhe skedat e sigurisë, dokumenta të cilat detyrimisht hartohen nga prodhuesi i produkteve, përmbajnë informacion të rreme për efekte kualifikimi, për sa kohë ky ofertues referuar bilanceve të tyre të publikuara në QKB nuk rezulton të kryejë aktivitet të ligshëm në fushën e prodhimit të detergjentëve.

3- Kërkojmë gjithashtu që pas verifikimit të pretendimeve tona ky operator ekonomik në përputhje me pikën 5 të nenit 76 kriteret detyruese për skualifikim të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ofertuesi “Anbim” SHPK, në kushtet kur ka paraqitur të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, të raportohet në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligjit të prokurimit publik. Duke shpresuar në një vlerësim të drejtë, objektiv, profesional nga ana juaj dhe në përputhje me qëllimet dhe parimet e ligjit të prokurimit publik, kërkojmë pranimin e plotë të ankesës tonë.

II.27. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3379/2 prot., datë 19.11.2024, janë

publikuar kriteret e kualifikimit të cilat operatori ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK.

II.28. Me shkresën e datës 26.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3379/3 prot., datë 26.11.2024 (nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), si dhe me shkresën nr. 1724/8 prot, datë 26.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3379/4 prot, datë 02.12.2024, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur mos pranimin ankesës nr. 3379 prot, datë 18.11.2024, të operatorit ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Anbim” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij më pretendimin se: “Kriteret e veçanta, kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2.2.1 operatori ekonomik ka paraqitur bilance të cilat kanë raport negativ (aktiv-pasiv) në vitet e njëpasnjëshme 2021-2022, 2022-2023”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.2.1 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.2.1. *Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2022, 2023 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Anbim” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Pasqyrat financiare për vitin 2021 të konfirmuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.
- Shkresën me nr. 997 prot., datë 14.07.2023 me objekt: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me çështjen nr. E0001116441, datë 13.07.2023, ju vëmë në dispozicion në formatin excel, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj në sistemin informatik për vitin 2022, dorëzuar elektronikisht me çështjen nr. E0001116441 pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë më datë 13.07.2023.
- Shkresën me nr. 7989 prot., datë 25.04.2024 me objekt: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me numër çështje E0001245191, datë 25.04.2024, po ju vëmë në dispozicion në formatin PD, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj në sistemin

informatik për vitin 2023, dorëzuar elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë më datë 30.03.2024.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Në nenin 21, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, thuhet shprehimisht: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”*

III.1.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.7. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.8. Neni 40/3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.9. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 4 dhe 6, parashikohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës”.

III.1.10. Në nenin 41, të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqeri audituese:*

a) të gjitha shoqerite tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, le cilat zbatojnë standardet ndërkombetare të raportimit financiar;

b) të gjitha shoqerite aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar - Standardet kombetare të kontabilitetit;

c) shoqerite me përgjegjësi të kufizuar, le cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombetare të kontabilitetit, kur në mbyllje të periudhës kontabel tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtem:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel perkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 miliona lekesh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 miliona lekesh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel.

III.1.11. Në nenin 14 “Kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit” të ligjit Nr. 8901, datë 23.05.2002 “Për Falimentimin i ndryshuar, parashikohet:

1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose të kreditorëve. Në rastin e personave juridikë procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore, kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë 3-vjeçare.

III.1.12. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion *me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet* në zbatim të nenit 77 të LPP-së.

III.1.13. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 *“Për prokurimin publik”* ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në

procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.14. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar “*Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2022, 2023 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*” Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.2 të këtij vendimi. Referuar testit të mësipërm të proporcionalitetit, KPP konstaton se synimi i autoritetit kontraktor me anë të kriterit të mësipërm është përmbushja me sukses e kontratës dhe për realizimin e synimit të mësipërm është parashikuar që bilancet e kërkuara nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, si edhe specififikimet teknike duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në interpretimin teleologjik të nenit 77 pika 3 të ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, KPP gjykon se qëllimi i normës së mësipërme juridike lidhet me vënien në dispozicion të autoriteteve kontraktore të mekanizmave ligjor mbi vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit (*avvard criteria*) me anë të cilave të vërtetohet se operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën. *Strictu sensu* ligjëvënësi ka parashikuar edhe mjetet ligjore (dokumentacionin ospisonal) që mund të dorëzohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për realizimin e synimit të normës juridike dhe njëherazi të qëllimit të autoritetit kontraktor si psh bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. KPP gjykon se kuadri ligjor në asnjë rast nuk parashikon se dorëzimi i bilancit të më shumë se një viti negativ (me humbje) tregon pa aftësinë financiare për përmbushjen me sukses të kontratës. Akoma më tej, vetë kuadri ligjor në fushën e procedurave tatimore, *lex specialis* ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nuk penalizon në asnjë rast subjektet juridikë në ushtrimin e aktivitetit të tyre tregëtar edhe në rast se rezulton se bilanci i një ose më shumë viteve rezulton me humbje (negativ). I vetmi penalizim parashikohet në ligjin nr. 8901 datë 23.05.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar, në të cilin referuar nenit 14 pika 1 parashikohet se *procedura e falimentit hapet me kërkesë të organeve tatimore kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë tre vjeçare*”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të drejtë kërkesën e autoriteteve kontraktore mbi dorëzimin e bilancave financiare për tre vitet e fundit të ushtrimit të aktivitetit tregëtar ushtrimor, si një e drejtë e cila rrjedh nga *lex specialis* dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Nga ana tjetër, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme lidhet *strictu sensu* me njohjen e aftësisë së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për të marrë pjesë në qarkullim civil si subjekt tregëtar si edhe duke shfaqur aftësi pagueuese ndaj të tretëve dhe ndaj shtetit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dëshmia se bilanci financiar

i një operatori ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi ka rezultuar me humbje për një ose disa vite nuk është një parakusht *sine qua non* që tregon pa afatësinë paguese të tij dhe njëherazi rrezikun potencial të mospërbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata publike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ndër parimet kryesore të përgatitjes së pasqyrave financiare, referuar Standardit Kombëtar të Kontabilitetit (SK) është ai *vijimësisë*. Parimi i *vijimësisë* që do të thotë se veprimtaria ekonomike e njësisë ekonomike do të ketë vijimësi dhe njëësia ekonomike nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj. Sa më sipër, KPP gjykon se një operator ekonomik nuk mund të skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit *ipso facto* se ka dëshmuar se një ndër pasqyrat financiare të aktivitetit financiar të këtij të fundit ka rezultuar me humbje, kur në asnjë rast nuk ka dëshmuar se ndodhet në kushtet e humbjeve në vijimësi (referuar parimit të SK), apo në gjendjen e insolvabilitetit. Gjithashtu, në nenin 77 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar parashikohet se “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”. Gjithashtu, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor çënon stimulimin e pjesëmarrjes së biznesit të vogël/mesëm në procedurat e prokurimit publik. Në një rast hipotetik, një operator ekonomik i cili ka nisur ushtrimin e aktivitetit tregëtar vetëm një vit para pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit publik nuk mund të disavantazohet/skualifikohet për faktin se bilanci financiar ka rezultuar me humbje. Gjithashtu, KPP gjykon se, pasqyrimi i humbjeve në bilanc vijnë për shkaqe të ndryshme si Humbja nga ndryshimi i kursit të këmbimit të kërkesave për t’u arkëtuar dhe detyrimeve për t’u paguar (për shembull, huat e dhëna dhe të marra) në monedhë të huaj e që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese), humbja në kapital, humbja nga shitjet; humbja nga veprimtaritë e shfrytëzimit, shkaqe të cilat jo drejtpërdrejtë lidhen me pa aftësinë paguese të pjesëmarrësve në procedurat e prokurimit publik. Sa më sipër, KPP gjykon se, *lex specialis*, ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar si edhe aktet nënligjore në zbatim të tij në asnjë rast nuk parashikonë se një operator ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik do të konsiderohet *prima facie* jo i aftë për përmbushjen e kapacitetit ekonomik në drejtim të përmbushjes së kontratës në rast se rezulton se bilanci i një ose më shumë viti është me humbje (negativ), për sa kohë që ky i fundit nuk është subjekt i ndalimeve të parashikuara nga ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligji nr. 8901 datë 23.05.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

III.1.15. Në kuptim të nenit 116 të Kushtetutës dhe “Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit Ndërmjet Komuniteteve Europiane E Shteteve Të Tyre Anëtare Dhe Republikës Së Shqipërisë”, neni 70 i së cilës parashikon se: “Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet”, Komisioni i Prokurimit Publik i referohet jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë së BE në vendimmarrjen e tij.

III.1.16. *Inter Allia dhe Mutatis Mutandis* në Çështjen C-218/11 *Édukóvízig dhe Hochtief Construction* GJED ka argumentuar se “*Niveli minimal i gjendjes ekonomike dhe financiare: GjD-ja konfirmoi se Direktiva e lejonte autoritetin kontraktues që të kërkonte një nivel minimal të gjendjes ekonomike dhe financiare (paragrafi 26). GjD-ja gjithashtu vuri në dukje se Direktiva e lejonte autoritetin kontraktues që të kërkonte nga operatorët ekonomikë që të siguronin dëshmi për atë gjendje përmes paraqitjes së bilancit të tyre. GjD-ja vërejtë më tej se, në përgjithësi, niveli minimal i gjendjes ekonomike dhe financiare nuk mund të përcaktohet duke iu referuar një bilanci. Prandaj, autoriteti kontraktues mund t’i referohet një apo më shumë aspekteve të veçanta të bilancit (paragrafët 26-27). GjD-ja konfirmoi se, në këtë kontekst, Direktiva i linte “një shkallë të drejtë lirie autoriteteve kontraktuese”. Sipas GjD-së, Direktiva “i autorizon shprehimisht autoritetet kontraktuese të zgjedhin referencat provuese të cilat duhet të paraqiten nga [operatorët ekonomikë] për të dhënë prova të gjendjes së tyre ekonomike dhe financiare”. GjD-ja theksoi se liria në dispozicion të autoriteteve kontraktuese nuk ishte e pakufizuar. Niveli i kapacitetit minimal i vendosur nga autoriteti kontraktues duhet të jetë i lidhur dhe proporcional në raport me lëndën e kontratës (paragrafi 29). Aspektet e bilancit të zgjedhur nga autoriteti kontraktues për të demonstruar nivelin minimal të gjendjes ekonomike dhe financiare duhet:*

- *Të sigurojë informacion objektiv për një gjendje të tillë*
- *Të përshtatet me madhësinë e kontratës në fjalë*
- *Të mos shkojnë përtej asaj që është e arsyeshme për qëllimin (paragrafi 2929)*

GjD-ja ballafaqoi vlerësimin e gjendjes ekonomike dhe financiare me vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale. GjD-ja deklaroi se, në lidhje me kapacitetet teknike dhe profesionale, Direktiva krijonte “një sistem të mbyllur i cili kufizon mënyrën e disponueshme për vlerësimin dhe verifikimin dhe, për këtë arsye, i kufizon [autoriteteve kontraktuese] mundësitë për të vendosur kërkesa” (paragrafi 28). GjD-ja vuri në dukje se legjislacioni i shteteve anëtare në lidhje me llogaritë vjetore të shoqërive nuk ishte subjekt i harmonizimit të plotë. Prandaj, nuk mund të përjashtohet që mund të ketë dallime në lidhje me një aspekt të veçantë të një bilanci. Mund të ketë dallime në aspektet e një bilanci me të cilat autoriteti kontraktues vendos një nivel minimal kapaciteti. [...]”.

III.1.17. Sa më sipër, KPP gjykon se, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes pasqyrohen të dhëna lidhur me pozitën financiare të këtij operatori ekonomik për periudhën 2021 -2022 -2023, lidhur me asetet xhiron, aktivet dhe pasivet, si dhe nuk konstatohet që të ketë raport negative midis aktiveve dhe passive në dy vite të njëpasnjëshme, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar operatori ekonomik ka dhënë një indicie që plotëson kriterin 2.2.1 dhe se referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç

përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. *Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë*”, autoriteti kontraktor ka në dispozicion momentin për kryerjen e verifikimeve apo kërkimin e sqarimeve operatorit ekonomik. Sa më sipër nëse autoriteti kontraktor kishte dyshime lidhur me dokumentacionin e dorëzuar duhet ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik apo pranë institucioneve të caktuara me ligj të posacëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Anbim” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Anbim” SHPK, për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar vlerësimit të kryer nga autoritetit kontraktor, rezulton se operatori ekonomik ankimues “Anbim” SHPK ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur kështu një interes të ligjshëm të ankohet për operatorë ekonomike të renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa më sipër, KPP gjykon, se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*.

Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Në rastin konkret, KPP konstaton, se operatori ekonomik “Anbim” SHPK, rezulton i klasifikuar me ofertë më të ulët ekonomike se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, rrjedhimisht duke mos patur interes mbi kualifikimin e këtij të fundit ose jo. Akoma më tej, referuar arsyetimit të këtij vendimi operator ekonomik “Anbim” SHPK, do të kualifikohet në këtë procedurë prokurimi, duke realizuar kështu interesin e tij të ligjshëm.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Anbim” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Besim Kamberi” PF, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me pretendimin se: *“Në dst, 2.3 kapaciteti teknik, pika 2.3.1 kërkohet: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqese deshmi për furnizimet e meparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit. - Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e meparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasinë dhe llojin e mallrave të furnizuara. - Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasinë dhe llojin e mallrave të furnizuara. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës. Duke mos plotësuar këtë kriter autoriteti kontraktor ka patur detyrimin që të skualifikojë operatorin ekonomik Euro Mega 2010”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqese deshmi për furnizimet e meparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e meparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasinë dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasinë dhe llojin e mallrave të furnizuara.

III.3.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Specifikimet teknike të materialeve të pastrimit.

1. Detergjentë larës për rroba.

Kërkohet të jetë cilësor, aktiv, me fuqi larëse zbardhuese, për larje me lavatriçe. Të jetë i përshtatshëm për larjen e rrobave të bardha dhe të atyre me ngjyra. Të heqë njollat dhe papastërtitë. Kërkesat cilësore të pluhurit larës për rroba janë si më poshtë:

- | | |
|---|-----------------------------|
| 1- Densiteti (pesha e litrit): | Jo më pak se 800 gr/liter |
| 2- Permbajtja e joneve: | H ⁺ pH 10-11 |
| 3- Tretshmeria ne uje: | Jo më pak se 99 % |
| 4- Permbajtja e lageshtires: | Jo më shumë se 1.5 % |
| 5- Aroma: | Me aromë të mirë, të lehtë. |
| 6- Permbajtja e lendeve tensioaktive: | 10-15 % |
| 7- Aftesia shkumuese | 2.5-3.0 cm |
| 8- Përmbajtja e perboratit te natriumit | 10-11% |
| 9- Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në qese plastike dhe të përmbajë në mënyrë qartësisht të dallueshme kodin e prodhimit të fabrikës. | |

Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

- | | |
|------------------------------|----------|
| 10- Pesha e nje konfeksioni: | 2 - 5 kg |
|------------------------------|----------|

2. Solucion larës enësh

Solucion lëng viskoz për larjen e enëve. Të jetë aktiv, cilësor në larjen e yndyrave. Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të solucionit për larje:

- | | |
|---|------------------------------|
| 1- Densiteti: | 1.0 – 1.1 gr/cm ³ |
| 2- Permbajtja e joneve H ⁺ | pH 6.5-7.5 |
| 3- Tretshmeria ne uje | 100% |
| 4- Aroma: | Pak aromë. |
| 5- Konsistenca e solucionit: | Lëng viskoz |
| 6- Permbajtja e lëndëve tensioaktive | 29-31 % |
| 7- Viskoziteti | 1750 (±250)cp |
| 8- Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në shishe plastike me grykë të ngushtë që lejon daljen me vështirësi të solucionit dhe të përmbajë në mënyrë qartësisht të dallueshme kodin e prodhimit të fabrikës. | |

Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

- | | |
|-----------------|------------|
| 9- Konfeksioni: | 0.5 – 1 kg |
|-----------------|------------|

3. Solucion larës dyshemeje (pllakash)

Të jetë aktiv, me fuqi larëse të njollave dhe papastërtive në pllaka, të jetë aromatic. Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------------|---|
| 1- Densiteti: | 0.95 - 1.00 gr/cm ³ |
| 2- Permbajtja e joneve: | pH 7-8 |
| 3- Tretshmeria ne uje: | 100% |
| 4- Paraqitja fizike e solucionit: | Lëng viskoz, homogjen. |
| 5- Aroma: | Me aromë të mirë, të lehtë. |
| 6- Permbajtja e lendeve tensioaktive: | 4.8 - 5 % |
| 7- Ambalazhimi: | Ambalazhim fabrike në bidon plastik dhe të përmbajë në mënyrë qartësisht të dallueshme kodin e prodhimit të fabrikës. |

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

- | | |
|-----------------|------------|
| 8- Konfeksioni: | 1- 5 litër |
|-----------------|------------|

4. Sapun tualeti

Të shkumëzojë mire në ujë të ngrohtë dhe të ftohtë me fortësi normale. Shkuma të jetë e qëndrueshme, të mos jetë ngjitëse dhe gjatë përdorimit të mos copëtohet.

Erë e këndshme, parfumi.

Kërkesat specifike të jenë si më poshtë:

- | | |
|------------------------|---|
| 1- Densiteti | 1 – 1.05 g/cm ³ |
| 2- Përmbajtja e joneve | PH 6-7 |
| 3- Tretshmëria | 98%-100% |
| 4- Pamja fizike | Sapun kallëp i ngurtë. |
| 5- Ngjyra e sapunit: | Me ngjyra të ndryshme. |
| 6- Peshja e sapunit | 80-90 gr. |
| 7- Aroma: | Me aromë të mirë, të lehtë. |
| 8- Ambalazhimi: | Ambalazhim fabrike në letër ku të jetë përcaktuar emërtimi dhe kodi i prodhuesit. |

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

5. Solucion për larje xhamash

Solucion larës xhamash, me efekt pastrimi të njollave dhe pluhurave në xhama.

Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- | | |
|-----------------------------------|-----------------------------------|
| 1. Densiteti: | 0.98-1.0 gr/cm ³ |
| 2. Permbajtja e joneve: | pH 6-7 |
| 3. Tretshmëria | 100% |
| 4. Paraqitja fizike e solucionit: | Solucion homogjen, lëng i pastër. |

5. Aroma: Me aromë të mirë, të lehtë.
6. Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike ne bidon plastik me sprucator dhe te permbaje kodin e prodhimit te fabrikës.

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

7. Konfeksioni: 0.5 - 1 liter

6. Solucion për pastrimin e sobave

Produkti të jetë profesional me përdorim të gjerë kundra yndyrës dhe i përshtatshëm për pastrimin e sobave të kuzhinës. I tretshëm në ujë dhe jo i dëmshëm për lëkurën e njeriut.

Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- 1- Densiteti 0.98-1.025 gr/cm³
- 2- Permbajtja e joneve H⁺ pH 10-11
- 3- Tretshmeria ne uje: 100%
- 4- Paraqitja fizike e solucionit: Solucion homogjen.
- 5- Aroma Me aromë të mirë, të lehtë.
- 6- Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike ne bidon plastik me sprucator dhe te permbaje kodin e prodhimit te fabrikës.

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkt i duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

- 7- Konfeksioni: 0.5 - 1 litër

7. Solucion zbardhues, dizinfektues rrobash

Kërkohe të ketë veti të mira zbardhuese dhe dezinfektuese.

Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- 1- Densiteti: 1.04 - 1.066 gr/cm³
- 2- Permbajtja e joneve H⁺ pH 12.5-14
- 3- Tretshmeria ne uje: 100%
- 4- Permbajtja e klorit 3.8 - 4 %
- 5- Aroma: Aromë shpuese e klorit.
- 6- Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike ne shishe plastike dhe te permbaje kodin e prodhimit te fabrikes.

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

- 7- Konfeksioni: 2 - 2.5 Litra.

8. Shtupa me bisht për larje dysHEMEJE.

Shtupa duhet të jetë me fibra viskoze tekstili, pambuku, me gjatësi 30-35 cm dhe me fileto për montimin e bishtit.

Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri.

Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e shtupës.

Gjatësia e bishtit 110-130 cm.

9. Fshesa pastrimi me bisht.

Fshesa për pastrimin e ambienteve të jashtme dhe të brendshme.

Fshesa të jetë me bazament plastik me gjatësi 25-27 cm, gjerësi 4-5 cm dhe me fije të gjata 8-10 cm dhe me fileto për montimin e bishtit. Të jenë plastike me fije të dendura dhe të buta.

Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri.

Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e fshesës.

Gjatësia e bishtit 110-130 cm.

10. Qese plastmasi për mbeturina

Te jenë rezistente, plastike, me përmasa 70x100 cm

Paketim në formë ruloje.

Pakoja të ketë 10 fije (qeska).

11. Sapuni i rrobave

Të jetë cilësor për larje rrobash dhe të heqë papastërtitë.

Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

1. Gjendja fizike: Sapun kallëp i ngurtë.
2. Aroma: Me aromë të mirë, të lehtë.
3. Densiteti: 1.1 - 1.2 gr/cm³
4. Përmbajtja e joneve: pH 6 - 7
5. Tretshmëria në ujë 98 – 100 %
6. Lartësia shkumuese 2.5 - 2.7 cm
7. Peshë e sapunit/copë 125 -130 gr
8. Ambalazhimi: Sapuni të jetë i paketuar me ambalazhim fabrike me qeske plastmasi të tejdukshme ku të jetë përcaktuar të dhënat e prodhuesit dhe kodi i fabrikes.

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

12. Peceta pastrimi

Të jenë të ambalazuara nga fabrika në pako. Çdo pako të përmbajë 3 copë.

Të jenë të forta dhe të lahen me ujë.

Pecetat duhet të kenë përmasat:

Gjerësi 36-40 cm

Gjatësi 38-42cm.

13. Doreza pastrimi

Të jenë rezistente për përdorim për larje muri e pllakash me nr. 7-8-9. Të jenë elastike në përdorim. Material latex.

Të jenë të paketuara me ambalazhin e fabrikës ku të dallohen qartë kodi i prodhuesit dhe të dhënat.

14. Sfungjer enësh

Të jenë nga njëra anë me fibër të fortë abrasive për pastrim sipërfaqesh të ashpra dhe nga ana tjetër sfungjer me pore të vogla.

Anësore të jenë me kanal përmbrojtjen e thonjëve.

Ambalazhimi të jetë nga fabrika ku të dallohen qartë kodi i prodhuesit dhe të dhënat.

15. Tel për pastrim enësh

Të jene të një madhësie mesatare, me përmbajtje inoxi, të përshtatshëm për larje tenxheresh dhe kazanësh. Ambalazhimi të jetë nga fabrika ku të dallohen qartë kodi dhe të dhënat e prodhuesit dhe me paketim çdo cope më vete ose paketime me jo më shumë se tre copë.

16. Kova plastike

Të jenë të një madhësie jo më pak se 15 litërshe, të pajisura me dorezë për ngritjen e kovës dhe aparatit shtrydhës për shtrydhjen e shtupës.

Të jetë material plastiki forte, i plotë dhe pesha totale e kovës sëbashku me shtrydhësen, të jetë jo më pak se 540 gr.

17. Solucion parketi

Solucioni për pastrim parketi të jetë me aromë të mire dhe me aftësi heqjen e njollave dhe shkëlqimin e sipërfaqeve të shtruara me parket.

Specifikimet teknike te solucionit të jenë si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1- Densiteti | 0.95 – 1.005 gr/cm ³ |
| 2- Përmbajtja e joneve H ⁺ | pH 7 - 8 |
| 3- Tretshmeria ne uje | 100% |
| 4- Paraqitja fizike | Solucion homogjen viskoz i pastër. |
| 5- Aroma | Me aromë të mirë, të lehtë. |

- 6- Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike ne bidon plastic dhe te permbaje kodin e prodhimit te fabrikes.

Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

- 7- Konfeksioni

0.75 - 5 litra

18. Peceta duarsh (kartopeceta)

Peceta e duarve do të shërbejnë për pastrimin e duarve pas ushqimit.

Përmasat e pecetës së hapur duhet të jenë si më poshtë:

Gjerësi: 28-30 cm

Gjatësi: 28-30 cm

Pesha specifike e pakos me peceta: 130-150 gr.

Paketim i përbërë nga jo më pak 70 fije peceta për 1 pako.

Përbërja: 100% celulozë

Ngjyra: Plotësisht e bardhë

Të paketuara në qeskë plastike të tejdukshme ku të jetë stampuar:

Marka e produktit, kodi dhe të dhënat e plota të prodhuesit, përmasat e pecetës, pesha specifike (neto) e pakos, numri i fijeve të pakos dhe përbërja.

19. Letër higjenike

Letrat higjenike duhet të jenë “rulonë” të paketuara në pako (qeske) me nga 10 rulonë secila.

Çdo rulon duhet të jetë i ndarë në jo më pak se 130 -150 nën-ndarje të vogla me përmasa:

Gjerësia e nën-ndarjes jo më pak se 9-10 cm

Gjatësia e nën-ndarjes jo më pak se 11-12 cm

Numri i shtresave të letrës: 3-4 shtresa.

Pesha specifike e një riloni: 100-150 gr

Përbërja: 100% celulozë.

Letrat higjenike duhet të jenë të paketuara në qeskë plastike të tejdukshme ku të jetë stampuar:

Marka e produktit, kodi dhe të dhënat e plota të prodhuesit, numri i rulonëve në një paketim, numri i nën-ndarjeve të një riloni, përmasat e nën-darjes, pesha specifike (neto) e një riloni, numri i shtresave të letrës dhe përbërja.

Informacion argumentues për hartimin e specifikimeve teknike

Për përgatitjen e specifikimeve teknike, komisioni i është referuar Ligjit nr. Nr. 10216, datë 21.01.2010 “Për detergjentët”, VKM nr. Nr.669, datë 28.9.2011 “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentët”.

Parametrat e përcaktuar në treguesit respektivë janë vendosur në raport me kërkesat e AK për sigurimin e artikujve cilësorë si në këndvështrimin fiziko-kimik por edhe në këndvështrimin sasior që ka të bëjë me volumin, peshën specifike apo përmasat e tyre.

Duke iu referuar nevojave specifike të çerdheve dhe Kopshteve në funksion të shërbimit të pastrimit cilësor, për të cilin shërbejnë këto materiale, nga gjithë shumëllojshmëria e artikuj vetë ngjashëm, të markava të ndryshme tregëtare, që gjenden në treg, janë përzgjedhur ata artikuj të cilët kanë karakteristika të njëjta edhe pse janë të markave tregëtare të ndryshme por që në raport me çmimin dhe specififikimet përkatëse për secilin prej tyre, plotësojnë më së miri si nga ana cilësore por edhe nga ana sasiore këtë shërbim, i cili merr një rëndësi të veçantë për derisa është në funksion të çerdheve dhe Kopshteve si qendra rezidenciale për fëmijë të grupmoshave nga 6 muaj deri në 6 vjeç.

Përsa i përket konfeksioneve të përcaktuara për secilin artikull, janë lënë hapësirat e nevojshme minimale dhe maksimale, referuar paketimeve që gjenden në treg, por duke patur gjithmonë parasysh që ato të jenë në funksion të realizimit sa më praktik dhe funksional të procesit të shpërndarjes së këtyre produkteve nëpër çerdhet dhe kopshtet e Tiranës, si dhe në funksion të procesit të magazinimit.

Përshkrimi i produkteve të kërkuara është bërë në mënyrë të detajuar duke përcaktuar në mënyrë të qartë produktin e kërkuar nga ana cilësore dhe sasiore, duke mos krijuar konfuzion mbi produktet e kërkuara.

Në lidhje me treguesit e përcaktuar në specififikimet e kërkuar për secilin produkt, kryesisht ato solucione, është e nevojshme të sqarojme se:

- Matja e densitetit është një parametër i rëndësishëm i cilësisë për produktet e pa përpunuara dhe të përfunduara në forma të ngurta dhe të lëngëta dhe kryhet me teknika të ndryshme. Matja e dendësisë, e cila është veçanërisht e rëndësishme në përcaktimin e pastërtisë së materialeve para përpunimit, është e rëndësishme për të përcaktuar nëse një material i huaj është i përzier me lëndën e parë. Nga ana tjetër ky tregues është në funksion të përcaktimit homogjenitetit të produktit.
- Treguesi i Ph (përmbajtja e joneve H^+) tek solucionet e lëngshme dhe sapunët është shumë e rëndësishme për të përcaktuar neutralitetin (as acid dhe as bazik), sepse në të dy rastet ndikon negativisht në shëndetin e fëmijëve. Ndërsa në rastin e detergjentit pluhur, dhe solucioneve për pastrimin e sobave, zbardhues dezinfektues rrobash, kërkohet me Ph më të lartë duke kaluar në bazë për arsye të ndikimit në emulsionet shkumuese.
- Tretshmëria e substancave në ujë është një nga kushtet kryesore që ndikon në formimin e përbërjes. Sa më e lartë të jetë tretshmëria, aq më të pastra janë produktet.
- Treguesi i lagështirës është shumë i rëndësishëm pasi lagështia ndikon negativisht në jetëgjatësinë e produktit (shpërbën substancat).
- Substancat teknioaktive-substancat organike ose përzierjet që janë lëndë përbërese të detergjentëve, që veprojnë në sipërfaqe dhe përbëhen nga një ose më shumë grupe hidrofille dhe hidrofobe dhe që kanë aftësinë të zvogëlojnë tensionin sipërfaqësor të ujit dhe të formojnë shtresa shpërndarëse ose thithëse monomolekulare në sipërfaqen e kontaktit ujë-ajër duke formuar emulsion ose mikroemulsione ose micela që thithen në kontakt me ujin dhe sipërfaqet e ngurta.
- Referuar përcaktimeve si “me aromë të mirë, të lehtë” në disa produkte objekt prokurimi sqarojme se, duke qënë se këto produkte janë parashikuar të përdoren në ambiente rezidenciale të frekuentuara nga fëmijë të moshave 6 muaj – 6 vjeç (çerdhe dhe kopshte) këshillohet që aromat e tyre të jenë sa më të lehta dhe të këndshme me

ndjeshmëri sa më të ulët në shqisën e të nuhaturit të fëmijëve. Gjithashtu sqarojmë se AK, në zbatim të parimeve të përcaktuara në LPP, me qëllim që mos të shmanget apo ngushtojë konkurrencën në këtë procedurë prokurimi, nuk ka përcaktuar aroma specifike (aroma konkrete si psh lulesh, frutash, bimësh etj), por ka konsideruar që përcaktimi “e mirë” dhe “e lehtë” është gjithpërfshirës.

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

1. Vërtetim Realizimi nr. 141/1 prot, datë 16.01.2024, për Kontratën nr. 303/27 Prot, datë 20.09.2023 lidhur ndërmjet Kuvendit dhe operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me vlerë të realizuar XXXXXXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi dhe fatura tatimore.
2. Vërtetim Realizimi nr. 193/7 prot, datë 12.09.2024, për Kontratën nr. 131/13 prot, datë 31.05.2022, lidhur ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë dhe operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me vlerë të realizuar XXXXXXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi dhe fatura tatimore.
3. Vërtetim Realizimi nr. 193/7 prot, datë 12.09.2024, për Kontratën nr. 563/6 prot, datë 20.04.2023, lidhur ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë dhe operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me vlerë të realizuar XXXXXXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi dhe fatura tatimore.
4. Vërtetim Realizimi nr. 193/7 prot, datë 12.09.2024, për Kontratën nr. 563/16 prot, datë 14.07.2023, lidhur ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë dhe operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me vlerë të realizuar XXXXXXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi dhe fatura tatimore.
5. Kontratë nr. 1116 prot, datë 08.09.2023, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Cerdheve dhe Kopshteve dhe operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me vlerë të realizuar XXXXXXXXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi dhe fatura tatimore.

III.3.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe*

judiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.3.7. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.8. Neni 40 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.3.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për

përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim.

III.3.10. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin *"2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit. - Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasinë dhe llojin e mallrave të furnizuara. - Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasinë dhe llojin e mallrave të furnizuara"*.

III.3.11. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike, KPP vëren, se ky operator ekonomik në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me dëshmit për furnizime të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ka dorëzuar kontratat e listuara në pikën III.3.3 të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i kontratave të sipërcituar, të paraqitur nga ky operator ekonomik, në përmbushje të kriterit për furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, nga krahasimi i elementëve si koha e realizimit të kontratave të dorëzuara, elementit ngjashmëri e kontratave (referuar zërave në faturat tatimore të paraqitura me zërat e prokuruar nga autoriteti kontraktor në kontratën objekt shqyrtimi), si dhe elementit vlerë të kontratave të deklaruara, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të furnizimeve të ngjashme të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat e autoritetit kontraktor, rezulton se në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit që kërkon të realizojë autoriteti kontraktor ka parashikuar mallrat si vijon *1 Detergjent rrobash; 2 Solucion larës enësh; 3 Sfungjer enësh; 4 Tel enësh; 5 Qese mbeturinash plasmasi; 6 Peceta pastrimi; 7 Solucion, zbardhues, dizifektues; 8 Ilaç xhamash (me sprucator); 9 Solucion pllakash; 10 Doreza pastrimi; 11 Sapun rrobash; 12 Sapun tualeti; 13 Kova (me mekanizem shtrydhje); 14 Fshesa me bisht; 15 Shtupa me bisht; 16 Solucion për pastrim sobave; 17 Solucion parketi; 18 Leter higjenike; 9 Peceta duarsh (kartopeceta)*. Nga krahasimi i kontratave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, faturave tatimore të shitjes, me formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik, parë kjo në rrafshin krahasimor me formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponentë do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 3 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike). KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i mallrave në faturat tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim këto kontrata të ngarkuara në PDF në sistemin e prokurimit elektronik:

1. Vërtetim Realizimi nr. 141/1 prot, datë 16.01.2024, për Kontratën nr. 303/27 Prot, datë 20.09.2023 lidhur ndërmjet Kuvendit dhe operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me

vlerë të realizuar XXXXXXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi dhe fatura tatimore.

2. Vërtetim Realizimi nr. 193/7 prot, datë 12.09.2024, për Kontratën nr. 131/13 prot, datë 31.05.2022, lidhur ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë dhe operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me vlerë të realizuar XXXXXXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi dhe fatura tatimore.

3. Vërtetim Realizimi nr. 193/7 prot, datë 12.09.2024, për Kontratën nr. 563/6 prot, datë 20.04.2023, lidhur ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë dhe operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me vlerë të realizuar XXXXXXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi dhe fatura tatimore.

4. Vërtetim Realizimi nr. 193/7 prot, datë 12.09.2024, për Kontratën nr. 563/16 prot, datë 14.07.2023, lidhur ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë dhe operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me vlerë të realizuar XXXXXXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi dhe fatura tatimore.

5. Kontratë nr. 1116 prot, datë 08.09.2023, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Cerdheve dhe Kopshteve dhe operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me vlerë të realizuar XXXXXXXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi dhe fatura tatimore.

Komisioni Prokurimit Publik shqyrtoi në themel kontratat e sipërcituara, dhe konstatoi se këto kontrata i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që janë brënda afatit tre vjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm me faturat tatimore të dorëzuara me zërat e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Nga përlllogaritja e kontratave faturave tatimore të paraqitura nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, rezulton se janë në vlerën XXXXXXXXX lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet kontratë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit. Sa më sipër, nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për kontratat e ngjashme të marrë në shqyrtim rezulton, se vlera e përgjithshme e furnizimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është XXXXXXXXX lekë pa TVSH, duke kaluar vlerën prej XXXXXXXX lekë pa TVSH që duhet të plotësonte ky operator dhe duke e përmbushur kriterin në lidhje me eksperiencën për furnizime të ngjashme, në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit. Rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK. Sa më lart, nga verifikimi i furnizimeve të ngjashme të realizuara dhe dokumentacionit shoqëruar të tyre, të paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka kryer punime të ngjashme me zërat në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses

të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, nga përlllogaritja e vlerës së furnizimeve të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, vlera e përgjithshme e furnizimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është XXXXXXXX lekë pa TVSH, pra arrin të kalojë vlerën prej XXXXXXXX lekë pa TVSH, vlerë e cila është e barazvlefshme me kërkesën e autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit në të cilën kërkohet jo më pak se 40 % e fondit limit. Nga verifikimi i zërave të ngjashme në faturat tatimore të kontratave të paraqitura nga ankimuesi si eksperiencia të ngjashme të mëparshme, nga përlllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, emërimit/përshkrimit, me zërat në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të kontratës objekt shqyrtimi, rezulton se operatori ekonomik ka arritur të dëshmojë se ka kryer kontrata të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, pra ka arritur të dëshmojë këtë realizm duke përmbushur dhe vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të kontratave të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik, KPP konstaton, se me anë të dokumentacionit të dorëzuar si më sipërcituar dëshmon, se ka kryer furnizime të ngjashme me zërat e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi duke dëshmuar se disponon eksperiencën e nevojshme për objektin e prokurimit. Komponentët e sipërcituar të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi kanë eksperiencë të ngjashme me ato të dëshmuara nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me anë të kontratave të sipërcituara, pasi dhe vetë tipologjia e saj është e ngjashme, referuar specifikimeve teknike dhe formularit të sasisë dhe grafikut të lëvrimit. Për sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.1 të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” PF nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” PF, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me pretendimin se: *“Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik Euro Mega 2010 nuk është i plotësuar në formatin e kërkuar sipas ligjit. Duke parë vendime të KPP-së mbi këtë operator ekonomik, si dhe paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të këtij operatori ekonomik na rezulton që nuk përmbushet në formën e duhur nga ligji. Konkretisht të gjitha fushat ku operatori ekonomik ka patur detyrimin të plotësojë për të dhënë informacion paraprak në mënyrë që AK të ketë akses për verifikimin e tyre nuk i ka plotësuar si dhe nuk janë të vulosura dhe firmosura në cdo faqe”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

- I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

1. Emër, atësi, amësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijsëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p>

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none">• Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.• Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.• Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me	Po [] Jo []

Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	
---	--

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën

shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.4.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Euro Mega 2010m” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	“EURO MEGA 2010” SHPK
Numri NIPT/et:	K91624505A
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Fushe Preze, Tirane, Shqipëri
Përfaqësuesi (emri):	
Telefoni:	
E-mail:	euromega2010@gmail.com

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

DEKLAROJ SE, NUK MBËSHTETEM NË KAPACITETET E OPERATORËVE TË TJERË EKONOMIKË DHE AS DO TË KEM NËNKONTRAKTORË PËR KËTË PROCEDURË PROKURIMI

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik **"EURO MEGA 2010" SHPK** është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjisllacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjisllacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:

Në adresën e ueb-it: [<https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Qendra Kombëtare e Regjistrimit]

Lloji i dokumentit: [EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"]

Operatori ekonomik **"EURO MEGA 2010" SHPK** nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:

Në adresën e ueb-it: [<https://e-albania.al>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë.]

Lloji i dokumentit: [Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore]

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

, e datëlindjes 26.10.1970, në cilësinë e Administrtorit të shoqërisë;

i datëlindjes 13.01.1965, në cilësinë e ortakut të shoqërisë.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: _____

Në adresën e ueb-it: [<https://e-albania.al>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë.]

Lloji i dokumentit: [Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore]

Operatori ekonomik **"EURO MEGA 2010" SHPK** nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme :

Në adresën e ueb-it: [<https://e-albania.al>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë.]

Lloji i dokumentit: [Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Në adresën e ueb-it: https://e-albania.al Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria Rajonale e Tatimeve] Lloji i dokumentit: [Vërtetim statusi aktiv]
Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Në adresën e ueb-it: [https://e-albania.al] Autoritetin ose organin lëshues: [OSHEE GROUP, Furnizuesi i Sherbimit Universal] Lloji i dokumentit: [Vërtetim Debite]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Në adresën e ueb-it: [https://e-albania.al] Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Bashkia Tirane; Bashkia Vore] Lloji i dokumentit: [Vertetim per pagimin e taksave dhe tarifave vendore/Vertetim per pagimin e sigurimeve shoqerore /Vërtetim për pagimin e detyrimeve tatimore]
Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme
Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfshirë nga drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme :
Në adresën e ueb-it: [https://eëb.app.gov.al/të-tjera/operator-ekonomik-të-përfshirë/]; Autoritetin ose organin lëshues: [Agjencia e Prokurimit Publik] Lloji i dokumentit: [Buletin i Njoftimeve Publike] si dhe Njoftim në EEB në adresën e cituar më sipër.

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Unë i nënshkruari _____, ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, "EURO MEGA 2010" SHPK në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
- Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
- Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
- Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
- Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
- Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- çmimet ;
 - metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, EURO MEGA 2010 SHPK ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:
- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; siguri; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet

vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.
Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).
Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.
Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".
Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none"> Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore,

operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.
 Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:


Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [X]

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [X] Nëse, po, numri i punonjësve: onjësve është: punonjës. <u>Profili i punonjësve:</u> Nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të kësaj procedurë prokurimi nuk janë përcaktuar kritere kualifikimi për tu përbushur në lidhje me profile të caktuara punonjësish. <u>Makineri e mjete</u> Po [X]

Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:				
Deklarojmë se, shoqëria disponon për këtë procedurë prokurimi automjetin me të dhënat e mëposhtme për të cilin deklarojmë se disponojmë të gjithë dokumentacionin e automjetit .				
Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtës	Statusi
1	DAIMLER CHRYSLER		(Masa maksimale e autorizuar)	Pronesi

Për Shoqërinë "EURO MEGA 2010" SHPK
 Emri, Mbiemri: ADMINISTRATORI -
 Firma:
 Vula:

 Data e dorëzimit të deklaratës: 25.10.2024

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.4.3. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashikuar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepr penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.4.4. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.5 Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë

dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, 42 sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 3. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.4.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j

) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.4.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse

ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në rastin konkret Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit. Në këtë formular vetëdeklarimi, shtojca 8 e DST, vërehet se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka plotësuar të gjitha vëndet të cilat janë të detyruara për tu plotësuar nga operatorët ekonomikë si dhe është firmosur dhe vulosur në cdo faqe. Në rastin konkret operatori ekonomik ka ofertuar sipas shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues e përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për paraqitjen e saktë të formularit të Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK i përmbush kriteret për kualifikim me paraqitjen e dokumentit Shtojca 8...., të plotësuar në të gjithë elementët përmbajtësorë të tij si dhe firmosur e vulosur, për të treguar vërtetësinë e të gjitha deklaratave por edhe përgjegjshmërinë për çka ka deklaruar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK e plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi ka paraqitur shtojcën 8 sipas formatit të rregullt, duke përmbushur “Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit.

KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” PF, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me pretendimin se: “Referuar ekstraktit të kësaj shoqërie shohim që vendet e ushtrimit të aktiviteti të saj janë: - Fshati Ahemtaq, Preze, prane firmes Ital Kon, Tiranë Selia Qëndrore. - Rruga e Kavajes, ndertim nje

katesh nr. 2, prane Ambasadës Turke, Tiranë. - Njesia Bashkiake nr. 6, Rruga Hamdi Pepa, nr. 8, brenda ambjenteve të tregut ushqimor, Tiranë. Praktikisht ky operator ekonomik për këto 3 vende të ushtrimit të aktivitetit do të duhet të ketë dokumentacionin përkatës lidhur me pika e) Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit (e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Përsakohë që ky operator ekonomik ka dorëzuar pranë ak vetëm një vërtetim debie sa i takon selisë qendrore dhe jo për kontratat aktive që ka me OSHEE, AK do të duhet të verifikojë me kujdes këtë vërtetim dhe në këtë kuadër kjo pikë është e pa plotësuar nga ky operator ekonomik. Si e tillë AK ka detyrimin ligjor të skualifikojë operatorin ekonomik Euro Mega 2010.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 1/a dhe 1/e “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret kualifikuese, si më poshtë vijon: “1. Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

III.5.2. Në shtojcën 7/2 “Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 1/a “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

III.5.3. Në dokumentat e tenderti të publikuara në Sistemin Elektronik të Prokurimit (SPE) nga ana e autoritetit kontraktor, pjesë përbërëse është edhe Shtojca nr. 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, ku në pjesën II Shkaqet e Përjashtimit, Deklarata A “Për Përmbushjen e Krieteve të Përgjithshme të Kualifikimit” parashikohet si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

III.5.4. Për përmbushjen e kritereve kualifikuese të përcaktuara në pikat 1/a dhe 1/e “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të Shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, operatori ekonomik ofertues “Euro Mega 2010” SHPK ka dorëzuar në dokumentacionin si me poshtë vijon:

- Shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” ku në seksionin A: “Deklarata për Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	“EURO MEGA 2010” SHPK
Numri NIPT/et:	K91624505A
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Fushe Preze, Tirane, Shqipëri
Përfaqësuesi (emri):	
Telefoni:	
E-mail:	euromega2010@gmail.com

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

DEKLAROJ SE, NUK MBËSHTETEM NË KAPACITETET E OPERATORËVE TË TJERË EKONOMIKË DHE AS DO TË KEM NËNKONTRAKTORË PËR KËTË PROCEDURË PROKURIMI

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:

Në adresën e ueb-it: [<https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Qendra Kombëtare e Regjistrimit]

Lloji i dokumentit: [EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"]

Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:

Në adresën e ueb-it: [<https://e-albania.al>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë.]

Lloji i dokumentit: [Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore]

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

, e datëlindjes 26.10.1970, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë;

, i datëlindjes 13.01.1965, në cilësinë e ortakut të shoqërisë.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: _____

Në adresën e ueb-it: [<https://e-albania.al>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë.]

Lloji i dokumentit: [Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore]

Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme :

Në adresën e ueb-it: [<https://e-albania.al>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë.]

Lloji i dokumentit: [Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore]
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Në adresën e ueb-it: https://e-albania.al</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria Rajonale e Tatimeve]</p> <p>Lloji i dokumentit: [Vërtetim statusi aktiv]</p>
<p>Operatori ekonomik EURO MEGA 2010 SHPK ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Në adresën e ueb-it: [https://e-albania.al]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [OSHEE GROUP, Furnizuesi i Sherbimit Universal]</p> <p>Lloji i dokumentit: [Vërtetim Debie]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Në adresën e ueb-it: [https://e-albania.al]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, Bashkia Tirane; Bashkia Vore]</p> <p>Lloji i dokumentit: [Vertetim per pagimin e taksave dhe tarifave vendore/Vertetim per pagimin e sigurimeve shoqerore /Vërtetim për pagimin e detyrimeve tatimore]</p>
<p>Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme :</i></p>
<p>Në adresën e ueb-it: [https://ëëë.app.gov.al/të-tjera/operator-ekonomik-të-përfjashtuar/;</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [Agjencia e Prokurimit Publik]</p> <p>Lloji i dokumentit: [Buletin i Njoftimeve Publike] si dhe Njoftim në ËEB në adresën e cituar më sipër.</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Unë i nënshkruari _____, ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **“EURO MEGA 2010” SHPK** në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
- Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
- Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
- Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
- Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
- Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- çmimet ;
 - metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

<p>Deklarata</p> <p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, EURO MEGA 2010” SHPK ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p> <p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <p>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrit, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.</p> <p>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet</p>
<p>vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.</p> <p>Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).</p> <p>Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.</p> <p>Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".</p> <p>Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.</p>

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

<p>Deklarata</p> <p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p>
<ul style="list-style-type: none"> Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHS). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore,

operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [X]

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [X] Nëse, po, numri i punonjësve: onjësve është: punonjës. <u>Profili i punonjësve:</u> Nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të kësaj procedurë prokurimi nuk janë përcaktuar kritere kualifikimi për tu përmbushur në lidhje me profile të caktuara punonjësish. <u>Makineri e mjete</u> Po [X]


	Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:				
	Deklarojmë se, shoqëria disponon për këtë procedurë prokurimi automjetin me të dhënat e mëposhtme për të cilin deklarojmë se disponojmë të gjithë dokumentacionin e automjetit .				
	Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtës	Statusi
	1	DAIMLER CHRYSLER		(Masa maksimale e autorizuar)	Pronesi

Për Shoqërinë "EURO MEGA 2010" SHPK

Emri, Mbiemri: ADMINISTRATORI -

Firma:

Vula:



Data e dorëzimit të deklaratës: 25.10.2024

- Ju lutemi sigurohuni që:**
- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
 - Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
 - Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
 - Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

- Vërtetim debie OSHEE-2024-8464270-YB, datë 25.10.2024, i lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, OSHEE GROUP, ku vërtetohet se: “Bazuar në deklaratimet e deklaruësit

(përfaqësuesit ligjor) Znj. R.Sh, vërtetojmë se kërkuesi “Euro Mega 2010” SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod), XXXXXXXXXX, XXXXXXXXXX, XXXXXXXXXX, përdorues i të cilave është “Euro Mega 2010” SHPK, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 25.10.2024, përfshirë faturën koherente të muajt Shtator 2024”.

- Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “*Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar*”, datë 25.10.2024, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, nëpërmjet shërbimeve elektronike në platformën E-albania, ku rezulton se e ushtron aktivitetin në këto adresa si më poshtë:

- 1- Zyra qendrore e shoqërisë fshati Ahmetaq, pranë firmës Ital Kon, Prezë, Tiranë.
- 2- Adresa dytësore Rruga e Kavajës, Nd. Nr. 2, pranë Ambasadës Turke.
- 3- Adresa dytësore Rruga “Hamdi Pepa”, Nr. 8, pranë ambjenteve të tregut ushqimorë, Tiranë.

III.5.5. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.5.6. Neni 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: “1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.5.7. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin Publik*” përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.5.8. Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur

autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.5.9. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme 96 vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..”.

III.5.10. Në nenin 40, pika 7/a të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;”.

III.5.11. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. *Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

6. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*

III.5.12. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.5.13. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.5.14. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike SPE Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “Euro Mega” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika

6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, A, parashikohet “*Deklaratë Për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme*”. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Euro Mega” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentin *Vërtetim debie OSHEE-2024-8464270-YB, datë 25.10.2024, i lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, OSHEE GROUP, ku vërtetohet se: “Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) Znj. Redina Shametaj, vërtetohet se kërkuesi “Euro Mega 2010” SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod), XXXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXX, përdorues i të cilave është “Euro Mega 2010” SHPK, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 25.10.2024, përfshirë faturën koherente të muajt Shtator 2024. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të autoritetit kontraktor rezulton se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur këtë dokumentacion edhe pranë AK të noterizuar. Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi me arsyen se: “Se ky operatorë ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor vetëm një vërtetim debiesë i takon selisë qendrore dhe jo për kontratat aktive që ka me OSHEE”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, i dorëzuar nga operatori ekonomik në SPE si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor, konstatohet, se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, për të provuar deklaratimet e tij për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, konkretisht pikës e) në dokumentet e tenderit, ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentin “*Vërtetim debie OSHEE-2024-8464270-YB, datë 25.10.2024, i lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, OSHEE GROUP, ku vërtetohet se: “Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) Znj. Redina Shametaj, vërtetohet se kërkuesi “Euro Mega 2010” SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod), XXXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXX, përdorues i të cilave është “Euro Mega 2010” SHPK, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 25.10.2024, përfshirë faturën koherente të muajt Shtator 2024”* lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA.

III.5.15. Në nenin 11 (*Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike*), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018, të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “*11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.*”.

III.5.16. Në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”

III.5.17. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit në Pjesën I: “Informacion në lidhje me operatorin ekonomik”, gërma “A”: dhe në pjesën II “Shkaqet e Përjashtimit”, gërma A “DEKLARATË “Për Përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimi”, ka deklaruar se “OE Euro Mega 2010 ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit sipas legjislacionit përkatës në fuqi”. Gjithashtu dhe nga verifikimi i ekstraktit të QKB rezulton, se ky operator ekonomik ushtron aktivitet në tre adresa, konkretisht 1- Zyra qendrore e shoqërisë fshati Ahmetaq, pranë firmës Ital Kon, Prezë, Tiranë. 2- Adresa dytësore Rruga e Kavajës, Nd. Nr. 2, pranë Ambasadës Turke. 3- Adresa dytësore Rruga “Hamdi Pepa”, Nr. 8, pranë ambjenteve të tregut ushqimorë, Tiranë. Gjithashtu, rezulton se ka dorëzuar në SPE dhe pranë autoritetit shitës, vërtetim nga OSHE sipas formatit të miratuar, me anë të së cilit vërtetohet, se Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) Znj. R. Sh, vërtetohet se kërkuesi “Euro Mega 2010” SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod), XXXXXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXXXX, përdorues i të cilave është “Euro Mega 2010” SHPK, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 25.10.2024, përfshirë faturën koherente të muajt Shtator 2024, pra nga sa më sipër rezulton se subjekti “Euro Mega 2010” SHPK nuk rezulton debitor për kontratën për kontratën (me kod), XXXXXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXXXX, përdorues i të cilave është “Euro Mega 2010” SHPK, vlerë e llogaritur deri më datë 25.10.2024, duke përfshirë edhe faturën e muajt Shtator 2024, ku referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit dt. 28.10.2024, nuk ka detyrime të papaguara, pasi sipas nenit 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht se: “Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do t’i dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit..”, ndërsa në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”.

III.5.18. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka dorëzuar në SPE dhe pranë autoritetit shitës vërtetim të lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA sipas formatit të miratuar, me anë të së cilit vërtetohet, se subjekti “Euro Mega 2010” SHPK disponon tre kontrata me Furnizuesin e Shërbimit Universal SHA dhe nuk rezulton debitor, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit, datë 28.10.2024. Gjithashtu, KPP gjykon, se institucioni i Furnizuesit të Shërbimit Universal SH.A menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjitha subjektet përdoruese të energjisë elektrike, për të gjitha kontratat e lidhura midis Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” PF nuk qëndrojnë.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” PF, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me pretendimin se: *“Referuar ekstraktit të kësaj shoqërie rezulton që administratori është znj. Redina Shametaj dhe ortak z. Hair Shametaj. Operatori ekonomik ka patur detyrimin ligjor për të deklaruar si dhe dorëzuar dokumentacion provues sa i takon pikave c), ç) dhe d) tek Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit: c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së; ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së; d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. Sa më sipër operatorit ekonomik Euro Mega 2010 ka patur detyrimin ligjor për të dorëzuar dokumentacion provues si për administratorin ashtu edhe për ortakun e saj për pikat e lartpërmendura.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 1/a dhe 1/e “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret kualifikuese, si më poshtë vijon: “1. Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit Ofertuesi deklaron se:

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

III.6.2. Në shtojcën 7/2 “Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 1/a “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

III.6.3. Në dokumentat e tenderti të publikuara në Sistemin Elektronik të Prokurimit (SPE) nga ana e autoritetit kontraktor, pjesë përbërëse është edhe Shtojca nr. 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, ku në pjesën II Shkaqet e Përrjashtimit, Deklarata A “Për Përmbushjen e Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit” parashikohet si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

Emër, atësi, amësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

III.6.4. Për përmbushjen e kriteve kualifikuese të përcaktuara në pikat 1/a dhe 1/e “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të Shtojcën 7 “Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, operatori ekonomik ofertues “Euro Mega 2010” SHPK ka dorëzuar në dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore nr. 15 prot, datë 22.07.2024 për shtetasen R. Sh, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton se ky shtetas është i Pa Dënuar.

- Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore nr. 20 prot, datë 22.07.2024 për shtetasin H. Sh, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton se ky shtetas është i Pa Dënuar.

- Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore nr. 11 prot, datë 25.10.2024 për subjektin Euro Mega 2010 me NIPT K91624505A, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton se ky subjekt është i Pa Dënuar.

- Shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” ku në seksionin A: “Deklarata për Përbushjen e Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit” ka deklaruar ku rezulton ortak z. Hair Shametaj dhe Administratore znj. Redina Shametaj, si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari Redina Shametaj, në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	“EURO MEGA 2010” SHPK
Numri NIPT/et:	K91624505A
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Fushe Preze, Tirane, Shqipëri
Përfaqësuesi (emri):	
Telefoni:	
E-mail:	euromega2010@gmail.com

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

DEKLAROJ SE, NUK MBËSHTETEM NË KAPACITETET E OPERATORËVE TË TJERË EKONOMIKË DHE AS DO TË KEM NËNKONTRAKTORË PËR KËTË PROCEDURË PROKURIMI

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:

Në adresën e ueb-it: [<https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Qendra Kombëtare e Regjistrimit]

Lloji i dokumentit: [EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"]

Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:

Në adresën e ueb-it: [<https://e-albania.al>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë.]

Lloji i dokumentit: [Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore]

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

_____ e datëlindjes 26.10.1970, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë;

_____ , i datëlindjes 13.01.1965, në cilësinë e ortakut të shoqërisë.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: _____

Në adresën e ueb-it: [<https://e-albania.al>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë.]

Lloji i dokumentit: [Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore]

Operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" SHPK nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme :

Në adresën e ueb-it: [<https://e-albania.al>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë.]

Lloji i dokumentit: [Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore]
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Në adresën e ueb-it: https://e-albania.al</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria Rajonale e Tatimeve]</p> <p>Lloji i dokumentit: [Vërtetim statusi aktiv]</p>
<p>Operatori ekonomik EURO MEGA 2010 SHPK ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Në adresën e ueb-it: [https://e-albania.al]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [OSHEE GROUP, Furnizuesi i Sherbimit Universal]</p> <p>Lloji i dokumentit: [Vërtetim Debie]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme:</i></p> <p>Në adresën e ueb-it: [https://e-albania.al]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, Bashkia Tirane; Bashkia Vore]</p> <p>Lloji i dokumentit: [Vertetim per pagimin e taksave dhe tarifave vendore/Vertetim per pagimin e sigurimeve shoqerore /Vërtetim për pagimin e detyrimeve tatimore]</p>
<p>Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme :</i></p>
<p>Në adresën e ueb-it: [https://ëëë.app.gov.al/të-tjera/operator-ekonomik-të-përfjashtuar/;</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [Agjencia e Prokurimit Publik]</p> <p>Lloji i dokumentit: [Buletin i Njoftimeve Publike] si dhe Njoftim në ËEB në adresën e cituar më sipër.</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

<p>Unë i nënshkruari ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, “EURO MEGA 2010” SHPK në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p> <ol style="list-style-type: none"> Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate; Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt; Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit; Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit; Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: <ol style="list-style-type: none"> paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme): <ol style="list-style-type: none"> Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër; <input checked="" type="checkbox"/> Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). <input type="checkbox"/>
--

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- çmimet ;
 - metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, EURO MEGA 2010” SHPK ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet
vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005). Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.
Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none"> Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore,

operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.
 Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:


Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [X]

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [X] Nëse, po, numri i punonjësve: onjësve është: punonjës. <u>Profili i punonjësve:</u> Nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të kësaj procedurë prokurimi nuk janë përcaktuar kritere kualifikimi për tu përmbushur në lidhje me profile të caktuara punonjësish. <u>Makineri e mjete</u> Po [X]

	Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:				
	Deklarojmë se, shoqëria disponon për këtë procedurë prokurimi automjetin me të dhënat e mëposhtme për të cilin deklarojmë se disponojmë të gjithë dokumentacionin e automjetit .				
	Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtës	Statusi
	1	DAIMLER CHRYSLER		(Masa maksimale e autorizuar)	Pronesi

Për Shoqërinë "EURO MEGA 2010" SHPK
Emri, Mbiemri: ADMINISTRATORI -
Firma:
Vula:

Data e dorëzimit të deklaratës: 25.10.2024

- Ju lutemi sigurohuni që:**
- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
 - Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
 - Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
 - Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

III.6.5. Në nenin 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcaktohet se;

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.6.6. Në nenin 76 pika , pika 3, gërma “g” të ligjit 162/2020 të LPP-së përcaktohet se: “3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

II.6.7. Në nenin 77 pika 1 të ligjit 162/2020 të LPP-së përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.6.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriteve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.6.9. Referuar sa më sipër në lidhje me formularin e vetëdeklarimit të shoqërisë “Euro Mega 2010” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se operatori ekonomik ankimues pretendon se *operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK nuk ka paraqitur dokumentet provuese pika c, ç, dhe d, personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së*”. Nga verifikimet e kryera nga dokumentacioni i dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet, se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, ka dorëzuar **1- Shtojcën 8, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” nga shqyrtimi i të cilit rezulton, se në pjesën e parë të tij është dhënë informacioni në lidhje me ortakun z. H. Sh dhe adimistratoren znj. R Sh, 2- Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore nr. 15 prot, datë 22.07.2024 për shtetasen Redina Shametaj (Lamaj, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton se ky shtetas është i Pa Dënuar. 3- Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore nr. 20 prot, datë 22.07.2024 për shtetasin H Sh, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton se ky shtetas është i Pa Dënuar. 4- Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore nr. 11 prot, datë 25.10.2024 për subjektin Euro Mega 2010 me NIPT K91624505A, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton se ky subjekt është i Pa Dënuar**. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e sipërcituar të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet, se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka dorëzuar, vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për ortakun, administratorin dhe subjektin “Euro Mega 2010” SHPK, nga ku rezulton se janë të padënuar. Komisioni vëren, se bazuar në nenin 26 të VKM Nr 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ligjvënësi në asnjë moment nuk ka kërkuar dokumentacion provues lidhur me pikën c të nenit 26 ku kërkohet “c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së”. Nga verifikimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se operatori ekonomik në fjalë ka dorëzuar këto dokumenta të noterizuara pranë AK, gjithashtu vetë autoriteti kontraktor në referim të Udhëzimit të Përbashkët të APP dhe Ministrisë së Drejtësisë nr. 1155 prot, datë 01.12.2019, ka verifikuar gjendjen gjyqësore të

përsonave të sipërpërmendur, edhe nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se ky operatorë ka paraqitur vërtetimet sipërcituara rreth lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nga ku rezulton se janë të padënuar. Gjithashtu theksojmë se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, të verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura. Vendosija e kriterëve të kualifikimit ka si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Komisioni vëren, se operatori ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK ka dorëzuar Vërtetimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për ortakun, administratorin dhe subjektin që nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-për personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik. Sa më lart KPP gjykon se operatori ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK ka plotësuar rubrikën Pjesa II Shkaqet e përjashtimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit duke dhënë informacionin që ky formular kërkon, si dhe ka paraqitur dokumentacion për këtë kriter si në sistemin e prokurimeve elektronike ashtu dhe pranë autoritetit kontraktor referuar informacionit të këtij të fundit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Besim Kamberi" PF nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Besim Kamberi" PF, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK me pretendimin se: "Në DST autoriteti kontraktor ka parashikuar në pikën 2.3.6 - ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: - Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi. - Mostrat duhet të jene në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe raport analizat dhe skedat teknike të sigurisë të depozituara në SPE.- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DOÇK-ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë. - Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër "emri i artikullit", datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit,

nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik. Mungesa e mostrës është kusht skualifikues. Ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: - Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi. - Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara dhe raport analizat dhe skedat teknike e të sigurisë të depozituara në SPE. - Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPÇK-ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë. - Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik. Mungesa e mostrës është kusht skualifikues. Nga dorëzimi i mostrave të këtij operatori ekonomik kemi vënë re mospërputhje të tyre me specifikimet teknike, konkretisht për artikujt si më poshtë: **Zëri nr. 6 “Peceta pastrimi”** Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (të jenë të ambalazhuara nga fabrika në pako. Çdo Pako të përmbajë 3 copë. Të jenë të forta dhe të lahen me ujë. Pecetat duhet të kenë përmasat: Gjerësi 36-40 cm gjatësi 38-42cm). Mostra e dorëzuar nga operatori ekonomik Euro Mega 2010 është i markes Miss Gravity e cila nuk përmban asnjë lloj të dhëne tjetër përvec barkodit dhe as emër prodhuesi apo amballazhuesi, nr. cel e të dhëna të tjera. Më kryesorja nuk përmban specifikimet teknike që ka kërkuar autoriteti kontraktor të cilat janë përmasat gjërësi 36-40 cm dhe gjatësi 38-42 cm. Me këtë produkt operatori ekonomik ka krijuar konfuzion dhe autoriteti kontraktor e ka pranuar duke mos pasur asnjë lloj informacioni që produkti është sipas specifikimeve. Duke mos pasur specifikimet e kërkuara nga AK, ky është një produkt shumë i lirë në treg cka ndikon drejtpërdrejtë në ofertimin e operatorëve ekonomik. Bashkëlidhur ankesës sonë do të gjeni foto për këtë produkt si dhe matjen që kemi kryer ku dallohen qartë përmasat e saj dhe mospërputhja me specifikimet teknike. **Zëri nr. 18 “Leter higjenike”** Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (letrat higjenike duhet të jenë “rulon” të paketuara në pako (qeske) me nga 10 rulon secila. Çdo rulon duhet të jetë i ndarë në jo më pak se 130 -150 nën-ndarje të vogla me përmasa: Gjerësia e nën-ndarjes jo më pak se 9-10 cm. Gjatësia e nën-ndarjes jo më pak se 11-12 cm. Numri i shtresave të letrës: 3-4 shtresa. Pesha specifike e një ruloni: 100-150 gr. Përbërja: 100% celulozë. Letrat higjenike duhet të jenë të paketuara në qeskë plastike të tejdukshme ku të jetë stampuar: marka e produktit, kodi dhe të dhënat e plota të prodhuesit, numri i rulonëve në një paketim, numri i nën-ndarjeve të një ruloni, përmasat e nën-darjes, pesha specifike (neto) e një ruloni, numri i shtresave të letrës dhe përbërja.) Mostra e dorëzuar nga operatori ekonomik Euro Mega 2010 është e markës Elisabet e prodhuar nga firma “Elisabet” import-export, rruga – Korçë - Bilisht, km 1. Ky produkt ka të shënuar të dhëna vetëm këto si më poshtë: shtresa - 3 shtresa rulona - 10 rulon prej 180 prerje Ndërkohë nuk ka të shënuar Gjerësin e nën-ndarjes ----- Gjatësin e nën-ndarjes ----- Perberja ----- . Pesha specifike e një ruloni është më kryesorja sepse letrat higjenike apo të duarve cmimi i tyre varjon vetëm nga pesha që ka produkti dhe lënda e parë blihet me kg dhe po ashtu cmimi vendoset në shitje për gramatur. Duke mos përshkruar peshën e saj operatori ekonomik mund të prodhojë një cilësi shumë të dobët duke ndikuar drejtpërdrejtë në cmimin e ofertuar dhe vendosur operatorët e tjerë në kushte jo të barabarta. Gjithashtu fakti që nuk ka asnjëlloj përshkrimi të përbërjes së saj (çka do të thotë që mund të jetë edhe e ricikluar) mund të rrezikojë shëndetin e fëmijëve duke patur parasysh rëndësinë e kësaj kontrate kur flasim për objektin dhe për kë kategori do të përdoren këto produkte. Bashkëlidhur ankesës sonë do të gjeni foto për këtë produkt ku dallohet qartë mospërputhja me

specifikimet teknike. **Zëri nr. 13 “Kova (me mekanizem shtrydhje)”** Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (të jenë të një madhësie jo më pak se 15 litërshë, të pajisura me dorezë për ngritjen e kovës dhe aparatën shtrydhës për shtrydhjen e shtupës. Të jetë material plastik i fortë, i plotë dhe pesha totale e kovës së bashku me shtrydhësen, të jetë jo më pak se 540 gr). Mostra e dorzuar nga operatori ekonomik Euro Mega 2010 është prodhim i kompanisë enes dhe në etiketën e produktit nuk ka asnjë lloj shënimi 560 gr. Bashkëlidhur ankesës sonë do të gjeni foto për këtë produkt ku dallohet qartë mospërputhja me specifikimet teknike. **Zëri nr. 14 “Fshesa me bisht”** Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (fshesa për pastrimin e ambienteve të jashtme dhe të brendshme. Fshesa të jetë me bazament plastik me gjatësi 25-27 cm, gjerësi 4-5 cm dhe me fije të gjata 8-10 cm dhe me fileto për montimin e bishtit. Të jenë plastike me fije të dendura dhe të buta. Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri. Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e fshesës. Gjatësia e bishtit 110-130 cm) Mostra e dorzuar nga operatori ekonomik Euro Mega 2010 është prodhim i kompanisë Cadi Group shpk Kosovë. Emërtimi i produktit është Cadi Ceaning. Ngjyra e kapakut është gri me gominë të verdhë anësore dhe fije fshese ngjyre gri dhe të verdhë. Në bazë të etiketës së produktit vem re që nuk ka të shënuar në asnjë lloj vendi sa janë përmasat e produktit, fijos, plastikës etj. Gjithashtu dhe bishti i dorëzuar nga operatori ekonomik është bisht metalik me veshje plastike ngjyrë e kuqe me kapat të zinj dhe nuk ka të shënuar në etiket gjatësin e bishtit por vetëm barkodin. Bashkëlidhur ankesës sonë do të gjeni foto për këtë produkt ku dallohet qartë mospërputhja me specifikimet teknike. **Zëri nr. 15 “Shtupa me bisht”** Specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë (shtupa duhet të jetë me fibra viskoze tekstili, pambuku, me gjatësi 30-35 cm dhe me fileto për montimin e bishtit. Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri. Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e shtupës. Gjatësia e bishtit 110-130 cm.) Mostra e dorzuar nga operatori ekonomik Euro Mega 2010 përmban vetëm emërtimin e prodhuesit por asnjëlloj të dhëne mbi specifikimet të cilat përshkruhen në kriter. Bashkëlidhur ankesës sonë do të gjeni foto për këtë produkt ku dallohet qartë mospërputhja me specifikimet teknike.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Specifikimet teknike të materialeve të pastrimit.

1. Detergjentë larës për rroba.

Kërkohet të jetë cilësor, aktiv, me fuqi larëse zbardhuese, për larje me lavatriçe. Të jetë i përshatshëm për larjen e rrobave të bardha dhe të atyre me ngjyra. Të heqë njollat dhe papastërtitë. Kërkesat cilësore të pluhurit larës për rroba janë si më poshtë:

1-	Densiteti (pesha e litrit):	Jo më pak se 800 gr/liter
2-	Permbajtja e joneve:	H+ pH 10-11
3-	Tretshmeria ne uje:	Jo më pak se 99 %
4-	Permbajtja e lageshtires:	Jo më shumë se 1.5 %

- | | | |
|-----|---|------------------------------------|
| 5- | <i>Aroma:</i> | <i>Me aromë të mirë, të lehtë.</i> |
| 6- | <i>Permbajtja e lendeve tensioaktive:</i> | <i>10-15 %</i> |
| 7- | <i>Aftesia shkumuese</i> | <i>2.5-3.0 cm</i> |
| 8- | <i>Përmbajtja e perboratit te natriumit</i> | <i>10-11%</i> |
| 9- | <i>Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në qese plastike dhe të përmbajë në mënyrë qartësisht të dallueshme kodin e prodhimit të fabrikës.</i> | |
| | <i>Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.</i> | |
| | <i>Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.</i> | |
| 10- | <i>Pesha e nje konfeksioni:</i> | <i>2 - 5 kg</i> |

2. Solucion larës enësh

Solucion lëng viskoz për larjen e enëve. Të jetë aktiv, cilësor në larjen e yndyrave. Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të solucionit për larje:

- | | | |
|----|---|------------------------------------|
| 1- | <i>Densiteti:</i> | <i>1.0 – 1.1 gr/cm³</i> |
| 2- | <i>Permbajtja e joneve H⁺</i> | <i>pH 6.5-7.5</i> |
| 3- | <i>Tretshmeria ne uje</i> | <i>100%</i> |
| 4- | <i>Aroma:</i> | <i>Pak aromë.</i> |
| 5- | <i>Konsistenca e solucionit:</i> | <i>Lëng viskoz</i> |
| 6- | <i>Permbajtja e lëndëve tensioaktive</i> | <i>29-31 %</i> |
| 7- | <i>Viskoziteti</i> | <i>1750 (±250)cp</i> |
| 8- | <i>Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në shishe plastike me grykë të ngushtë që lejon daljen me vështirësi të solucionit dhe të përmbajë në mënyrë qartësisht të dallueshme kodin e prodhimit të fabrikës.</i> | |
| | <i>Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.</i> | |
| | <i>Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.</i> | |
| 9- | <i>Konfeksioni:</i> | <i>0.5 – 1 kg</i> |

3. Solucion larës dyshemeje (pllakash)

Të jetë aktiv, me fuqi larëse të njollave dhe papastërtive në pllaka, të jetë aromatic. Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- | | | |
|----|---|--------------------------------------|
| 1- | <i>Densiteti:</i> | <i>0.95 - 1.00 gr/cm³</i> |
| 2- | <i>Permbajtja e joneve:</i> | <i>pH 7-8</i> |
| 3- | <i>Tretshmeria ne uje:</i> | <i>100%</i> |
| 4- | <i>Paraqitja fizike e solucionit:</i> | <i>Lëng viskoz, homogjen.</i> |
| 5- | <i>Aroma:</i> | <i>Me aromë të mirë, të lehtë.</i> |
| 6- | <i>Permbajtja e lendeve tensioaktive:</i> | <i>4.8 - 5 %</i> |

7- *Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në bidon plastik dhe të përmbajë në mënyrë qartësisht të dallueshme kodin e prodhimit të fabrikës.*

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

8- *Konfeksioni: 1- 5 litër*

4. Sapun tualeti

Të shkumëzojë mire në ujë të ngrohtë dhe të ftohtë me fortësi normale. Shkuma të jetë e qëndrueshme, të mos jetë ngjitëse dhe gjatë përdorimit të mos copëtohet.

Erë e këndshme, parfumi.

Kërkesat specifike të jenë si më poshtë:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1- <i>Densiteti</i> | <i>1 – 1.05 g/cm³</i> |
| 2- <i>Përmbajtja e joneve</i> | <i>PH 6-7</i> |
| 3- <i>Tretshmëria</i> | <i>98%-100%</i> |
| 4- <i>Pamja fizike</i> | <i>Sapun kallëp i ngurtë.</i> |
| 5- <i>Ngjyra e sapunit:</i> | <i>Me ngjyra të ndryshme.</i> |
| 6- <i>Pesha e sapunit</i> | <i>80-90 gr.</i> |
| 7- <i>Aroma:</i> | <i>Me aromë të mirë, të lehtë.</i> |
| 8- <i>Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në letër ku të jetë përcaktuar emërtimi dhe kodi i prodhuesit.</i> | |

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

5. Solucion për larje xhamash

Solucion larës xhamash, me efekt pastrimi të njollave dhe pluhurave në xhama.

Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- | | |
|--|--|
| 1. <i>Densiteti:</i> | <i>0.98-1.0 gr/cm³</i> |
| 2. <i>Permbajtja e joneve:</i> | <i>pH 6-7</i> |
| 3. <i>Tretshmëria</i> | <i>100%</i> |
| 4. <i>Paraqitja fizike e solucionit:</i> | <i>Solucion homogjen, lëng i pastër.</i> |
| 5. <i>Aroma:</i> | <i>Me aromë të mirë, të lehtë.</i> |
| 6. <i>Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike në bidon plastik me sprucator dhe të përmbajë kodin e prodhimit të fabrikës.</i> | |

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

7. *Konfeksioni: 0.5 - 1 liter*

6. Solucion për pastrimin e sobave

Produkti të jetë profesional me përdorim të gjerë kundra yndyrës dhe i përshtatshëm për pastrimin e sobave të kuzhinës. I tretshëm në ujë dhe jo i dëmshëm për lëkurën e njeriut.

Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- | | | |
|----|--|-------------------------------|
| 1- | Densiteti | 0.98-1.025 gr/cm ³ |
| 2- | Permbajtja e joneve H ⁺ | pH 10-11 |
| 3- | Tretshmeria ne uje: | 100% |
| 4- | Paraqitja fizike e solucionit: | Solucion homogjen. |
| 5- | Aroma | Me aromë të mirë, të lehtë. |
| 6- | Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike ne bidon plastik me sprucator dhe te permbaje kodin e prodhimit te fabrikës. | |

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkt i duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

- | | | |
|----|--------------|---------------|
| 7- | Konfeksioni: | 0.5 - 1 litër |
|----|--------------|---------------|

7. Solucion zbardhues, dizinfektues rrobash

Kërkohet të ketë veti të mira zbardhuese dhe dezinfektuese.

Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- | | | |
|----|---|---------------------------------|
| 1- | Densiteti: | 1.04 - 1.066 gr/cm ³ |
| 2- | Permbajtja e joneve H ⁺ | pH 12.5-14 |
| 3- | Tretshmeria ne uje: | 100% |
| 4- | Permbajtja e klorit | 3.8 - 4 % |
| 5- | Aroma: | Aromë shpuese e klorit. |
| 6- | Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike ne shishe plastike dhe te permbaje kodin e prodhimit te fabrikes. | |

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

- | | | |
|----|--------------|----------------|
| 7- | Konfeksioni: | 2 - 2.5 Litra. |
|----|--------------|----------------|

8. Shtupa me bisht për larje dyshemeje.

Shtupa duhet të jetë me fibra viskoze tekstili, pambuku, me gjatësi 30-35 cm dhe me fileto për montimin e bishtit.

Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri.

Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e shtupës.

Gjatësia e bishtit 110-130 cm.

9. Fshesa pastrimi me bisht.

Fshesa për pastrimin e ambienteve të jashtme dhe të brendshme.

Fshesa të jetë me bazament plastik me gjatësi 25-27 cm, gjerësi 4-5 cm dhe me fije të gjata 8-10 cm dhe me fileto për montimin e bishtit. Të jenë plastike me fije të dendura dhe të buta.

Bishti të jetë prej materiali plastik, metali me veshje plastike, ose druri.

Fileto e bishtit të jetë konike dhe të përputhet me filetimin e fshesës.

Gjatësia e bishtit 110-130 cm.

10. Qese plastmasi për mbeturina

Te jenë rezistente, plastike, me përmasa 70x100 cm

Paketim në formë ruloje.

Pakoja të ketë 10 fije (qeska).

11. Sapuni i rrobave

Të jetë cilësor për larje rrobash dhe të heqë papastërtitë.

Kërkesat specifike të solucionit të jenë si më poshtë:

- | | | |
|----|--|------------------------------------|
| 1. | <i>Gjendja fizike:</i> | <i>Sapun kallëp i ngurtë.</i> |
| 2. | <i>Aroma:</i> | <i>Me aromë të mirë, të lehtë.</i> |
| 3. | <i>Densiteti:</i> | <i>1.1 - 1.2 gr/cm³</i> |
| 4. | <i>Përmbajtja e joneve:</i> | <i>pH 6 - 7</i> |
| 5. | <i>Tretshmëria në ujë</i> | <i>98 – 100 %</i> |
| 6. | <i>Lartësia shkumuese</i> | <i>2.5 - 2.7 cm</i> |
| 7. | <i>Pesha e sapunit/copë</i> | <i>125 -130 gr</i> |
| 8. | <i>Ambalazhimi: Sapuni të jetë i paketuar me ambalazhim fabrike me qeske plastmasi të tejdukshme ku të jetë përcaktuar të dhënat e prodhuesit dhe kodi i fabrikes.</i> | |

Data e skadencës jo me pak se një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

12. Peceta pastrimi

Të jenë të ambalazhuara nga fabrika në pako. Çdo pako të përmbajë 3 copë.

Të jenë të forta dhe të lahen me ujë.

Pecetat duhet të kenë përmasat:

Gjerësi 36-40 cm

Gjatësi 38-42cm.

13. Doreza pastrimi

Të jenë rezistente për përdorim për larje muri e pllakash me nr. 7-8-9. Të jenë elastike në përdorim. Material latex.

Të jenë të paketuara me ambalazhin e fabrikës ku të dallohen qartë kodi i prodhuesit dhe të dhënat.

14. Sfungjer enësh

Të jenë nga njëra anë me fibër të fortë abrasive për pastrim sipërfaqesh të ashpra dhe nga ana tjetër sfungjer me pore të vogla.

Anësore të jenë me kanal përmbrojtjen e thonjëve.

Ambalazhimi të jetë nga fabrika ku të dallohen qartë kodi i prodhuesit dhe të dhënat.

15. Tel për pastrim enësh

Të jene të një madhësie mesatare, me përmbajtje inoxi, të përshtatshëm për larje tenxheresh dhe kazanësh. Ambalazhimi të jetë nga fabrika ku të dallohen qartë kodi dhe të dhënat e prodhuesit dhe me paketim çdo cope më vete ose paketime me jo më shumë se tre copë.

16. Kova plastike

Të jenë të një madhësie jo më pak se 15 litërshe, të pajisura me dorezë për ngritjen e kovës dhe aparatit shtrydhës për shtrydhjen e shtupës.

Të jetë material plastiki forte, i plotë dhe pesha totale e kovës sëbashku me shtrydhësen, të jetë jo më pak se 540 gr.

17. Solucion parketi

Solucioni për pastrim parketi të jetë me aromë të mire dhe me aftësi heqjen e njollave dhe shkëlqimin e sipërfaqeve të shtruara me parket.

Specifikimet teknike te solucionit të jenë si më poshtë:

- | | | |
|----|---|------------------------------------|
| 1- | Densiteti | 0.95 – 1.005 gr/cm ³ |
| 2- | Permbajtja e joneve H ⁺ | pH 7 - 8 |
| 3- | Tretshmeria ne uje | 100% |
| 4- | Paraqitja fizike | Solucion homogjen viskoz i pastër. |
| 5- | Aroma | Me aromë të mirë, të lehtë. |
| 6- | Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike ne bidon plastic dhe te permbaje kodin e prodhimit te fabrikes. | |

Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e prezantimit te produktit.

Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2023.

- | | | |
|----|-------------|----------------|
| 7- | Konfeksioni | 0.75 - 5 litra |
|----|-------------|----------------|

18. Peceta duarsh (kartopeceta)

Peceta e duarve do të shërbejnë për pastrimin e duarve pas ushqimit.

Përmasat e pecetës së hapur duhet të jenë si më poshtë:

Gjerësi: 28-30 cm

Gjatësi: 28-30 cm

Pesha specifike e pakos me peceta: 130-150 gr.

Paketim i përbërë nga jo më pak 70 fije peceta për 1 pako.

Përbërja: 100% celulozë

Ngjyra: Plotësisht e bardhë

Të paketuara në qeskë plastike të tejdukshme ku të jetë stampuar:

Marka e produktit, kodi dhe të dhënat e plota të prodhuesit, përmasat e pecetës, pesha specifike (neto) e pakos, numri i fijeve të pakos dhe përbërja.

19. Letër higjenike

Letrat higjenike duhet të jenë “rulonë” të paketuara në pako (qeske) me nga 10 rulonë secila.

Çdo rulon duhet të jetë i ndarë në jo më pak se 130 -150 nën-ndarje të vogla me përmasa:

Gjerësia e nën-ndarjes jo më pak se 9-10 cm

Gjatësia e nën-ndarjes jo më pak se 11-12 cm

Numri i shtresave të letrës: 3-4 shtresa.

Pesha specifike e një ruloni: 100-150 gr

Përbërja: 100% celulozë.

Letrat higjenike duhet të jenë të paketuara në qeskë plastike të tejdukshme ku të jetë stampuar:

Marka e produktit, kodi dhe të dhënat e plota të prodhuesit, numri i rulonëve në një paketim, numri i nën-ndarjeve të një ruloni, përmasat e nën-darjes, pesha specifike (neto) e një ruloni, numri i shtresave të letrës dhe përbërja.

Informacion argumentues për hartimin e specifikimeve teknike

Për përgatitjen e specifikimeve teknike, komisioni i është referuar Ligjit nr. Nr. 10216, datë 21.01.2010 “Për detergjentët”, VKM nr. Nr.669, datë 28.9.2011 “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentët”.

Parametrat e përcaktuar në treguesit respektivë janë vendosur në raport me kërkesat e AK për sigurimin e artikujve cilësorë si në këndvështrimin fiziko-kimik por edhe në këndvështrimin sasior që ka të bëjë me volumin, peshën specifike apo përmasat e tyre.

Duke iu referuar nevojave specifike të çerdheve dhe Kopshteve në funksion të shërbimit të pastrimit cilësor, për të cilin shërbejnë këto materiale, nga gjithë shumëllojshmëria e artikujve vetë ngjashëm, të markava të ndryshme tregëtare, që gjenden në treg, janë përzgjedhur ata artikuj të cilët kanë karakteristika të njëjta edhe pse janë të markave tregëtare të ndryshme por që në raport me çmimin dhe specifikimet përkatëse për secalin prej tyre, plotësojnë më së miri si nga ana cilësore por edhe nga ana sasimore këtë shërbim, i cili merr një rëndësi të veçantë për derisa është në funksion të çerdheve dhe Kopshteve si qendra rezidenciale për fëmijë të grupmoshave nga 6 muaj deri në 6 vjeç.

Përsa i përket konfeksioneve të përcaktuara për secilin artikull, janë lënë hapësirat e nevojshme minimale dhe maksimale, referuar paketimeve që gjenden në treg, por duke patur gjithmonë parasysh që ato të jenë në funksion të realizimit sa më praktik dhe funksional të procesit të shpërndarjes së këtyre produkteve nëpër çerdhet dhe kopshtet e Tiranës, si dhe në funksion të procesit të magazinimit.

Përshkrimi i produkteve të kërkuara është bërë në mënyrë të detajuar duke përcaktuar në mënyrë të qartë produktin e kërkuar nga ana cilësore dhe sasiore, duke mos krijuar konfuzion mbi produktet e kërkuara.

Në lidhje me treguesit e përcaktuar në specifikimet e kërkuar për secilin produkt, kryesisht ato solucione, është e nevojshme të sqarojme se:

- Matja e densitetit është një parametër i rëndësishëm i cilësisë për produktet e pa përpunuara dhe të përfunduara në forma të ngurta dhe të lëngëta dhe kryhet me teknika të ndryshme. Matja e dendësisë, e cila është veçanërisht e rëndësishme në përcaktimin e pastërtisë së materialeve para përpunimit, është e rëndësishme për të përcaktuar nëse një material i huaj është i përzier me lëndën e parë. Nga ana tjetër ky tregues është në funksion të përcaktimit homogjenitetit të produktit.

- Treguesi i Ph (përmbajtja e joneve H⁺) tek solucionet e lëngshme dhe sapunët është shumë e rëndësishme për të përcaktuar neutralitetin (as acid dhe as bazik), sepse në të dy rastet ndikon negativisht në shëndetin e fëmijëve. Ndërsa në rastin e detergjentit pluhur, dhe solucioneve për pastrimin e sobave, zbardhues dezinfektues rrobash, kërkohet me Ph më të lartë duke kaluar në bazë për arsye të ndikimit në emulsionet shkumuese.

- Tretshmëria e substancave në ujë është një nga kushtet kryesore që ndikon në formimin e përbërjes. Sa më e lartë të jetë tretshmëria, aq më të pastra janë produktet.

- Treguesi i lagështirës është shumë i rëndësishëm pasi lagështia ndikon negativisht në jetëgjatësinë e produktit (shpërbën substancat).

- Substancat teksoaktive-substancat organike ose përzierjet që janë lëndë përbërëse të detergjentëve, që veprojnë në sipërfaqe dhe përbëhen nga një ose më shumë grupe hidrofille dhe hidrofobe dhe që kanë aftësinë të zvogëlojnë tensionin sipërfaqësor të ujit dhe të formojnë shtresa shpërndarëse ose thithëse monomolekulare në sipërfaqen e kontaktit ujë-ajër duke formuar emulsion ose mikroemulsione ose micela që thithen në kontakt me ujin dhe sipërfaqet e ngurta.

- Referuar përcaktimeve si “me aromë të mirë, të lehtë” në disa produkte objekt prokurimi sqarojme se, duke qënë se këto produkte janë parashikuar të përdoren në ambiente rezidenciale të frekuentuara nga fëmijë të moshave 6 muaj – 6 vjeç (çerdhe dhe kopshte) këshillohet që aromat e tyre të jenë sa më të lehta dhe të këndshme me ndjeshmëri sa më të ulët në shqisën e të nuhaturit të fëmijëve. Gjithashtu sqarojmë se AK, në zbatim të parimeve të përcaktuara në LPP, me qëllim që mos të shmanjë apo ngushtojë konkurrencën në këtë procedurë prokurimi, nuk ka përcaktuar aroma specifike (aroma konkrete si psh lulesh, frutash, bimësh etj), por ka konsideruar që përcaktimi “e mirë” dhe “e lehtë” është gjithpërfshirës.

III.7.2. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3. “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.5 dhe 2.3.6. të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.5. Vetëm për produktet:

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i produktit</i>
1	<i>Detergjent rrobash</i>
2	<i>Solucion larës enësh.</i>
3	<i>Solucion, zbardhues, dizifektues</i>
4	<i>Ilaç xhamash</i>
5	<i>Solucion pllakash</i>
6	<i>Sapun rrobash</i>
7	<i>Sapun tualeti</i>
8	<i>Solucion për pastrimin e sobave</i>
9	<i>Solucion parketi</i>

OE duhet të paraqesë:

a) **Raport Analizë** nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), ose laborator tjetër ekuivalent.

Raport Analiza duhet të përmbajë të gjithë treguesit dhe parametrat e kërkuar për secilin produkt në specifikimet teknike.

b) **Skedat Teknike dhe Skedat e Sigurisë të tyre.**

Në skedat teknike dhe skedat e sigurisë të produktit, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kërkuara me produktet e ofruara.

(Skedat teknike dhe skedat e sigurisë duhet të jenë në gjuhën shqipe, dhe nëse janë në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer e të noterizuara)

2.3.6 Ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe raport analizat dhe skedat teknike e të sigurisë të depozituara në SPE.
- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë D. P. Ç. K - ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

III.7.3. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Në nenin 92/3 të LPP-së i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.7.4. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

III.7.5. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga

operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.7.6. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues, në datën dhe orën e hapjes së procedurës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin nga artikujt objekt-prokurimi, si dhe mostrat duhet të jene në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe raport analizat dhe skedat teknike të sigurisë të depozituara në SPE, ndërkohë që në kriterin 2.3.5 ka përcaktuar që vetëm për produktet 1- *Detergjent rrobash*, 2 -*Solucion larës enësh*, 3- *Solucion, zbardhues, dizifektues*, 4- *Ilaç xhamash*, 5- *Solucion pllakash*, 6- *Sapun rrobash*, 7- *Sapun tualeti*, 8- *Solucion për pastrimin e sobave*, 9- *Solucion parketi*, për këto produkte është kërkuar a) **raport analizë** nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), ose laborator tjetër ekuivalent. Raport Analiza duhet të përmbajë të gjithë treguesit dhe parametrat e kërkuar për secilin produkt në specifikimet teknike dhe b) **skedat teknike dhe skedat e sigurisë të tyre**. Në skedat teknike dhe skedat e sigurisë të produktit, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kërkuara me produktet e ofruara. Nisur nga pretendimet e ankimesit për operatorin ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK, Komisioni Prokurimit Publik konstatoi, se OE “*Euro Mega 2010*” SHPK ka dorëzuar mostrat për të gjitha artikujt objekt-prokurimi të kërkuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se nga verifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit rezulton se në shtojcën 7 “*Kriteret e Veçanta*” të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor nuk është përcaktuar asnjë kriter i posaçëm kualifikimi në lidhje me paraqitjen e një testi nga laborator të akredituar, paraqitjes së standarteve apo edhe mundësinë e dorëzimit të katalogëve apo ndonjë dokumentacion tjetër për plotësimin e specifikimeve teknike, për të gjithë mostrat e kërkuara por vetëm për produktet 1- *Detergjent rrobash*, 2 -*Solucion larës enësh*, 3- *Solucion, zbardhues, dizifektues*, 4- *Ilaç xhamash*, 5- *Solucion pllakash*, 6- *Sapun rrobash*, 7- *Sapun tualeti*, 8- *Solucion për pastrimin e sobave*, 9- *Solucion parketi*, ndërsa në lidhje me mostrat e tjera për të cilat ngren pretendime edhe ankimesi si për produktet 6- *Peceta pastrimi*, 13- *Kova (me mekanizëm shtrydhje)*, 14- *Fshesa me bisht*, 15- *Shtupa me bisht*, 18- *Leter higjenike*, autoriteti kontraktor është mjaftuar me verifikimet e mostrave vetëm me çfarë është shkruar në paketimin e mostrës, pavarësisht se në asnjë moment në kriteret e veçanta për kualifikim nuk është kërkuar që krahasimi i mostrës nëse i përmbush specifikimet teknike të kërkuara në shtojcën 5, do të përmbushen me informacionin e shkruar në paketimin e mostrës. Specifikimet teknik dhe kriteret e veçanta të kualifikimit janë dy momente të ndryshme juridike. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar në nenin 77 të ligjit për prokurimin publik diskrecionin mbi të cilat

autoriteti kontraktor mund të hartojë kriteret e veçanta të kualifikimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 3 të Vendimit nr. 285 datë. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se: “1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave. 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Pra, në mënyrë eksplicite është parashikuar se në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Në rastin konkret autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar asnjë kriter apo dokument konkret që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë në lidhje me plotësimin e ndonjë kriteri mbi dokumentacionin, mbi paraqitjen e një testi nga laborator të akredituar, paraqitjen e standarteve, raport analizave apo dhe skedave teknike për produktet 6- Peceta pastrimi, 13- Kova (me mekanizem shtrydhje), 14- Fshesa me bisht, 15- Shtupa me bisht, 18- Leter higjenike, ose që mostrat duhet të dorëzohen me etiketë ose të kenë të shkruar specifikimet teknike në paketimet e tyre sikundër pretendohet nga autoriteti kontraktor. Pra në rastin konkret, KPP nuk mund të shprehet mbi mënyrën e përmbushjes së kriterëve hipotetike kur në dokumentet e procedurës së prokurimit nuk është parashikuar një kërkesë e tillë, ashtu sikurse është përcaktuar për produktet në kriterin 2.3.5 të DST. Në lidhje me përmbushjen e specifikimeve teknike KPP sqaron se në nenin 87, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: “4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit”, i jep të drejtë autoritetit kontraktor që të kryejë verifikime sa i përket përmbushjes së specifikimeve teknike nga ana e operatorëve ekonomikë, gje që të cilën autoriteti kontraktor nuk e ka ushtruar. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter apo specifikim tjetër, i cili nuk është i përfshirë në dokumentet e tenderit. Autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë ofertuesit pjesëmarrës vetëm për atë që ka kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Një ndër qëllimet kryesore të ligjit për prokurimin publik është ai i sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues

për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Parimi i mosdiskrimimit është një ndër elementet kyçe në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave dhe se ofertat e operatorëve ekonomikë nuk mund të vlerësohen referuar kriterëve jo të shprehura në dokumentet e procedurës së prokurimit. Gjithashtu, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht nenin 124 *“Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”* të Ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor, ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues *“Besim Kamberi”* PF nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik *“Besim Kamberi”* PF ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik *“Anbim”* SHPK., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik *“Euro Mega 2010”* SHPK përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik *“Anbim”* SHPK, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“Euro Mega 2010”* SHPK, për shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik *“Anbim”* SHPK me pretendimin se: *“Për gjithë sa më sipër, kërkojmë shtimin e arsyeve për skualifikim për ofertën e dorëzuar nga ofertuesi “Anbim” SHPK, sipas arsyetimit të bërë në këtë ankesë, si oferta të cilat nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor e konkretisht: për Ofertuesin “Anbim” SHPK, të shtohen arsyet për skualifikim: I- Ofertuesi “Anbim” SHPK nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit e konkretisht kriteret për kualifikim të përcaktuara në pikën 1/g) dhe 1/h) të shtojcës 7 të DT-së me përmbajtjet si më poshtë vijojnë: “...g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës dhe h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, pasi e ushtron aktivitetin e*

prodhimin të detergjentave, i papajisur me leje mjedisore të tipi A ose dhe të Tipit B në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar; 2- Nuk plotëson kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.5/b) të kapacitetit teknik të shtojcës 7 të DT-së mëpërmbajtjen si vijon: “?2.3.5.vetëm për produktet: Nr emërtimi i produktit 1- Detergjent rrobash, 2- Solucion larës enësh, 3- Solucion zbardhues, dizifektues, 4- Ilaç xhamash, 5- Solucion pllakash, 6- Sapun rrobash, 7- Sapun tualeti, 8- Solucion për pastrimin e sobave, 9- Solucion parketi. b) Skedat Teknike dhe Skedat e Sigurisë të tyre. Në skedat teknike dhe skedat e sigurisë të produktit, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kerkuara me produktet e ofruara. (Skedat teknike dhe skedat e sigurisë duhet të jenë në gjuhën shqipe, dhe nëse janë në gjuhë të huaja duhet të jenë të përkthyer e të noterizuara), pasi skedat teknike dhe skedat e sigurisë, dokumenta të cilat detyrimisht hartohen nga prodhuesi i produkteve, përmbajnë informacion të rreme për efekte kualifikimi, për sa kohë ky ofertues referuar bilanceve të tyre të publikuara në QKB nuk rezultojnë të kryejnë aktivitet të ligshëm në fushën e prodhimit të detergjentëve. 3- Kërkojmë gjithashtu që pas verifikimit të pretendimeve tona ky operator ekonomik në përputhje me pikën 5 të nenit 76 kriteret detyruese për skualifikim të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ofertuesi “Anbim” SHPK, në kushtet kur ka paraqitur të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, të raportohet në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligjit të prokurimit publik. Duke shpresuar në një vlerësim të drejtë, objektiv, profesional nga ana juaj dhe në përputhje me qëllimet dhe parimet e ligjit të prokurimit publik, kërkojmë pranimin e plotë të ankesës tonë” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1 Në datën 26.09.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr.REF-21632-09-25-2024, me objekt “Blerje Materiale Pastrimi”, me fond limit 16.562.250 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa T.V.SH ose 167.329 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njëzetë e nëntë) Euro, kursi kembimit 98.98 all/euro, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë, datë 25.09.2024, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.10.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

III.9.2. Në datën 28.10.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

III.9.3. Referuar informacionit të Autoritetit Kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezultojnë se në datën 31.10.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Anbim” SHPK	11,884,900	lekë skualifikuar
2. “Euro Mega 2010” SHPK	11,999,500	lekë kualifikuar
3. “Besim Kamberi” PF	12,188,500	lekë kualifikuar

4. “Murati D” SHPK	12,421,800	lekë kualifikuar
5. “Atlantik 3” SHPK	13,550,000	lekë skualifikuar
6. “I&V Company” SHPK	13,629,500	lekë kualifikuar
7. “Malvina Visoka” PF	16,196,000	lekë skualifikuar

III.9.4. Në datën 31.10.2024, operatori ekonomik “Euro Mega” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

III.9.5. Në datën 05.11.2023, është Publikuar Njoftim - Fituesi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

III.9.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 15.11.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2023/4799, dhe nr. 3379/2024 prot, datë 18.11.2024 e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, nëpërmjet së cilës kërkon lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Anbim” SHPK në këtë procedurë prokurimi.

III.9.7. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3379/2 prot., datë 19.11.2024, janë publikuar kriteret e kualifikimit të cilat operatori ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK.

III.9.8. Me shkresën e datës 26.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3379/3 prot., datë 26.11.2024 (nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), si dhe me shkresën nr. 1724/8 prot, datë 26.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3379/4 prot, datë 02.12.2024, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur mos pranimin ankesës nr. 3379 prot, datë 18.11.2024, të operatorit ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK.

III.9.9. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.9.10. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.9.11. Në nenin 111, pika 1 dhe 4 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik. 2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.”

III.9.12. Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. “4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.

III.9.13. Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankesë tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.3.14. Referuar bazës ligjore të sipërcituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, është 10 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit paraprak (05.11.2024), ka qenë data 14.11.2024. Në këtë kuadër, ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik është paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike në datë 15.11.2024, pra jashtë afateve të ankimit, kur ndërkohë duhet të ishte dorëzuar jo më vonë se në datën 14.11.2024, si pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 111, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon shprehimisht se: “Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike”. Në rastin konkret, ankesa e operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110, pika 1 e LPP i cili parashikon, se “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”. Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak 05.11.2024 dhe përfundon në ditën e 10-të. Në rastin konkret data e publikimit të njoftimit fituesit paraprak është 05.11.2024 ndërkohë ankesa e paraqitur nga ankimuesi në autoritetin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, është data 15.11.2024, jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar racione temporis. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji stricto sensu ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit

njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Në rastin konkret vërtetohet, se ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afateve të parashikuara ligjore të ankimimit. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit në autoritet kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

Rrjedhimisht pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr.REF-21632-09-25-2024, me objekt “Blerje Materiale Pastrimi”, me fond limit 16 562 250 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa T.V.SH ose 167 329 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njëzetë e nëntë) Euro, kursi kembimit 98.98 all/euro, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë, datë 25.09.2024, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.10.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF për procedurën e prokurimit më sipër cituar.

3. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega” SHPK për procedurën e prokurimit më sipër cituar.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Anbim” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operatorë ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “Besim Kamberi” PF.
8. Ngarkohet zyra e finances, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri